



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 47

Tiranë – E martë, 3 mars 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 27.2.2026	Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, për realizimin e projektit “Ndërtimi i muzeut arkeologjik nëntokësor, parkimi nëntokësor dhe rehabilitimi i sheshit ‘Nënë Tereza’”..... 3431
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 114, datë 27.2.2026	Për krijimin, mbajtjen dhe funksionimin e regjistrit elektronik të personave, për të cilët është vendosur moslejimi për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit, në faqe interneti, në aplikacione ose në platformë elektronike, ku mund të luhen lojërat e fatit, sipas kategorisë së licencuar, si dhe rregullat për paraqitjen, shqyrtimin, miratimin, anulimin apo refuzimin e kërkesës për moslejimin e personave për të hyrë në ambientet e lojërave të fatit..... 3431
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 27.2.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 206, datë 7.4.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin indirekt dhe ushtrimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të programit për zhvillimin rural të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPARD III)” 3434
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 27.2.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 966, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPARD II (2014–2020), sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural” 3435
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 27.2.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 540, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësisë dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)” 3435

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 27.2.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 541, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësi dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA II (2014–2020)”..	3436
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 27.2.2026	Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore”, me nënprojektet si “Korpusi i institucioneve të pavarura”, “Qendra për Zhvillimin Multifunksional Tiranë” dhe “Copëzat”	3437
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 27.2.2026	Për miratimin e rregullave për organizimin, të kriterëve, të mënyrës së mbështetjes dhe të masës së shpërblimit financiar për të rinjtë në Programin e Talenteve Rinore.....	3439
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 27.2.2026	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror të Arsimit Parauniversitar.....	3447
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 122, datë 27.2.2026	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS).....	3449
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 123, datë 27.2.2026	Për revokimin e transferimit të së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve të pasurive nr. 4/870 dhe nr. 4/871, në zonën kadastrale 8270, me vendndodhje në Tiranë.....	3451
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 27, datë 13.2.2026	Për caktimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë.....	3458
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 37, datë 2.3.2026	Për caktimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.....	3458
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 177, datë 20.2.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	3458
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 22.1.2026	Çështja Arben Biçaku kundër Shqipërisë dhe Klodian Rjepaj kundër Shqipërisë (<i>kërkesat nr. 45354/16 dhe 56514/21</i>).....	3460
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 22.1.2026	Çështja Mirelë Buzalli kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 385/22</i>).....	3461
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 27.1.2026	Çështja Zyberi kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 24267/16</i>).....	3463

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore
për Shpronësimin nr. 368/6,
datë 2.3.2026

Për disa shtesa dhe ndryshime, në vendimin nr. 445, datë 31.7.2025,
“Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të
paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Për
zbatimin e projektit të portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në
Porto-Romano”

**VENDIM****Nr. 111, datë 27.2.2026**

**PËR NGARKIMIN E FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, SI
AUTORITET KONTRAKTOR, PËR
KRYERJEN E PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK, PËR
REALIZIMIN E PROJEKTIT
“NDËRTIMI I MUZEUT
ARKEOLOGJIK NËNTOKËSOR,
PARKIMI NËNTOKËSOR DHE
REHABILITIMI I SHESHIT
‘NËNË TEREZA’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, për realizimin e projektit “Ndërtimi i muzeut arkeologjik nëntokësor, parkimi nëntokësor dhe rehabilitimi i sheshit ‘Nënë Tereza’”.

2. Në funksion të zbatimit të projektit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ngarkohet të kryejë:

a) të gjitha procedurat, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratat përkatëse për projektimin, zbatimin e mbikëqyrjen e projektit, si dhe të ndjekë zbatimin e tyre e të projektit përkatës;

b) paraqitjen e kërkesave për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit në emër të institucioneve publike përfituese pranë autoritetit kompetent të zhvillimit të territorit, si dhe ndjekjen e të gjitha veprimeve e të procedurave të nevojshme për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për zhvillimin e territorit.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Bashkia Tiranë mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi, në funksion të zhvillimit të projektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Bashkia Tiranë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 114, datë 27.2.2026**

**PËR KRIJIMIN, MBAJTJEN DHE
FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT
ELEKTRONIK TË PERSONAVE, PËR TË
CILËT ËSHTË VENDOSUR MOSLEJIMI
PËR T’U FUTUR NË AMBIENTET E
LOJËRAVE TË FATIT, NË FAQE
INTERNETI, NË APLIKACIONE OSE
NË PLATFORMË ELEKTRONIKE, KU
MUND TË LUHEN LOJËRAT E FATIT,
SIPAS KATEGORISË SË LICENCUAR, SI
DHE RREGULLAT PËR PARAQITJEN,
SHQYRTIMIN, MIRATIMIN,
ANULIMIN APO REFUZIMIN E
KËRKESËS PËR MOSLEJIMIN E
PERSONAVE PËR TË HYRË NË
AMBIENTET E LOJËRAVE TË FATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****1. Ky vendim përcakton:**

a) krijimin e regjistrit elektronik të personave, për të cilët është vendosur moslejimi për t’u futur në ambientet e lojërave të fatit apo në faqe interneti, në aplikacione ose në platformë elektronike, ku mund të luhen lojëra fati, sipas kategorisë së licencuar;

b) rregullat për paraqitjen, shqyrtimin, miratimin, anulimin apo refuzimin e kërkesës për moslejimin e personit për të hyrë në ambientet e lojërave të fatit, në faqe interneti, në aplikacione ose në platformë



elektronike, ku mund të luhen lojëra fati, sipas kategorisë së licencuar;

c) rregullat e mbajtjes e të funksionimit të regjistrit elektronik të personave, për të cilët është vendosur moslejimi për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit, në faqe interneti, në aplikacione ose në platformë elektronike, ku mund të luhen lojëra fati, sipas kategorisë së licencuar.

2. Ky vendim ka si qëllim, gjithashtu, parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e pasojave socio-ekonomike të lidhura me frekuentimin e lojërave të fatit nga ana e personave që shfaqin probleme me përdorimin e lojërave të fatit, probleme, të cilat kërcënojnë seriozisht stabilitetin financiar familjar e individual të lojtarit.

3. Regjistri elektronik i personave, për të cilët është vendosur moslejimi për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit apo në faqe interneti, në aplikacione ose në platformë elektronike, ku mund të luhen lojëra fati, sipas kategorisë së licencuar (në vijim “Regjistri”), administrohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes të Lojërave të Fatit (në vijim “AMLF”).

4. Regjistri do të jetë i aksesueshëm nga të gjithë organizatorët e lojës së fatit të kategorisë përkatëse, të licencuar sipas ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

II. RREGULLAT E DETAJUARA PËR PARAQITJEN, SHQYRTIMIN, MIRATIMIN, ANULIMIN APO REFUZIMIN E KËRKESËS PËR MOSLEJIM

1. Kërkesa për moslejimin e një personi për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit apo në faqe interneti, në aplikacione ose në platformë elektronike bëhet nëpërmjet portalit “*e-Albania*” nga vetë lojtari ose nga një prej familjarëve të tij, si bashkëshorti/ja, prindërit, fëmija i rritur ose një person tjetër, që jeton me lojtarin në të njëjtën familje. AMLF-ja ruan të dhënat e gjeneruara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Kërkesa për moslejimin për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit apo në faqe interneti, në aplikacione ose në platformë elektronike plotësohet sipas formatit standard të miratuar dhe të publikuar nga AMLF-ja në faqen e saj të internetit.

3. Kërkesa përfshin informacionin, si: emrin dhe mbiemrin e lojtarit, letërnjoftimin/pasaportën, adresën dhe të dhënat e kontaktit, fotografinë e lojtarit, periudhën e moslejimit të kërkuar, si dhe llojin e lojërave për të cilat kërkohet moslejimi.

4. Në rastet kur kërkesa bëhet nga vetë lojtari, AMLF-ja, brenda 2 (dy) ditëve nga paraqitja e kërkesës, pas verifikimit të identitetit të kërkuarit, vendos për pranimin e kërkesës, duke bërë pasqyrimin në regjistrin menjëherë. Kërkuari njoftohet për vendimin me shkrim edhe nëpërmjet portalit “*e-Albania*”.

5. Vendimi përmban:

- a) emrin dhe mbiemrin e lojtarit;
- b) adresën dhe të dhënat e kontaktit të lojtarit;
- c) afatin e moslejimit për të luajtur lojëra fati;
- ç) llojin e lojës së fatit.

6. Në rastet kur kërkesa bëhet nga një prej familjarëve të lidhur me lojtarin, përveç informacionit të përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu, kërkesa mund të shoqërohet me vetëdeklarimin që lojtari ka probleme serioze personale ose në familje nga përdorimi i lojërave të fatit. Deklarimi i problemeve me përdorimin e lojërave të fatit duhet të shoqërohet edhe me dokumentacion mjekësor apo i lidhur me procese gjyqësore/vendim gjyqësor, që faktojnë problemet e lojtarit me përdorimin e lojërave të fatit, probleme, të cilat kërcënojnë seriozisht stabilitetin financiar, familjar e individual të lojtarit.

7. Pas marrjes së kërkesës, titullari i AMLF-së, brenda 5 (pesë) ditëve, shqyrton dokumentacionin dhe vendos:

a) Të miratojë kërkesën në rastet kur dokumentacioni është i plotë dhe përmban të dhëna identifikuese të qarta për gjendjen problematike të lojtarit, pa u kufizuar në vërtetimet/deklarimet e renditura në pikën 5 të këtij kreu; ose

b) Të refuzojë kërkesën, duke sqaruar në vendim arsyet dhe shkaqet e refuzimit të kërkesës. Si shkaqe për refuzim kërkesë janë kur kërkesa nuk është bërë nga personi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe praktika dokumentare e paraqitur nuk identifikon, apo provon gjendjen problematike të lojtarit në përdorimin e lojërave të fatit. Në rastet e miratimit të kërkesës, vendimi përmban të njëjtat elemente si në pikën 4 të këtij kreu.

8. AMLF-ja njofton kërkuarin me shkrim në adresë postare/nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për vendimin e marrë.



9. Pas përfundimit të afatit të moslejimit, të miratuar sipas kërkesës, AMLF-ja fshin nga regjistri informacionin për moslejimin. AMLF-ja njofton lojtarin nëpërmjet portalit “*e-Albania*”.

10. Kërkuesi, ndaj të cilit është dhënë një vendim nga AMLF-ja për moslejimin për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit apo në faqe interneti, në aplikacione ose në platformë elektronike, ka të drejtën të paraqesë një kërkesë anulimi të këtij vendimi pranë AMLF-së, por jo më parë se 3 (tre) muaj nga data hyrjes në fuqi të vendimit.

11. Kërkesa për anulim paraqitet nga personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu dhe përmban argumentet, arsyet e faktet, që provojnë ndryshimin e rrethanave mbi të cilat ishte akorduar vendimi për moslejimin e lojtarit, si dhe çdo dokumentacion shoqërues që disponon kërkuesi.

12. AMLF-ja shqyrton kërkesën për anulim vendimi brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kësaj kërkesë dhe vendos:

a) të miratojë kërkesën për anulimin e vendimit në rastet kur provohet dhe identifikohet qartë ndryshimi i rrethanave të lojtarit dhe nuk ekzistojnë më pengesat e shkakët për moslejim të lojtarit për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit apo në faqe interneti, në aplikacione ose në platformë elektronike; ose

b) të refuzojë kërkesën për anulim të vendimit, në rastet kur konstatohet se kërkesa e paraqitur nuk provon ndryshimin e rrethanave dhe të fakteve, mbi të cilat është marrë vendimi për moslejim të lojtarit.

13. AMLF-ja njofton kërkuesin me shkrim në adresë postare/nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për vendimin e marrë.

III. RREGULLAT E MBAJTJES E TË FUNKSIONIMIT TË REGJISTRIT TË PERSONAVE, PËR TË CILËT ËSHTË VENDOSUR MOSLEJIMI PËR T'U FUTUR NË AMBIENTET E LOJËRAVE TË FATIT

1. Të dhënat parësore janë të dhënat e mbledhura nga AMLF-ja. Të dhënat parësore janë të dhënat e mëposhtme:

- Kodi unik identifikues i lojtarit që nuk lejohet;
- Kërkesa/formulari i aplikimit;
- Dokumenti shoqërues mjekësor apo i lidhur me procese gjyqësore/vendim gjyqësor, nëse ka;
- Statusi i kërkesës;
- Lloji i lojës, për të cilën zbatohet moslejimi;
- Periodha e moslejimit, nga _____ deri _____.

2. Të dhënat dytësore, të cilat merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore dhe me të cilat ndërvepron, janë, si më poshtë vijon:

a) Të dhënat e individit dhe adresa nga baza e të dhënave shtetërore “Regjistri kombëtar i gjendjes civile” dhe “Regjistri kombëtar i adresave”, të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

b) Informacioni i kontaktit nga baza e të dhënave shtetërore, portali unik qeveritar “*e-Albania*”;

c) Të dhënat e subjektit (NUIS), organizatori i licencuar nga baza e të dhënave shtetërore Regjistri Tregtar dhe Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, të administruara nga Qendra Kombëtare e Biznesit (për identifikimin e subjekteve, të cilat do të kenë akses në listën e personave që nuk lejohen).

3. Të gjitha veprimet e kryera në bazën e të dhënave janë të gjurmueshme e të dokumentuara dhe ruhen duke përdorur kodin identifikues të personit të ngarkuar që ka kryer veprimin, datën e orën e konsultimit, fjalët kyç të përdorura për kërkimin, numrin e dosjes dhe të dhënat e konsultuara.

4. AMLF-ja është përgjegjëse për menaxhimin, në përputhje me këtë vendim, të informacionit e aksesimit në bazën e të dhënave. Në rast të konstatimit të veprimeve të paautorizuara dhe të veprimeve që keqpërdorin të dhënat personale, AMLF-ja pezullon menjëherë aksesin e personit, i cili ka vepruar në kundërshtim me ligjin, apo udhëzimet e procedurat për administrimin e bazës së të dhënave. Pezullimi i aksesit nuk përjashton përgjegjësinë disiplinore administrative, civile ose penale.

5. Mirëmbajtja dhe funksionimi i regjistrit bëhen në përputhje me kërkesat dhe rregullat për administrimin e bazës së të dhënave, masat e marra për sigurinë e bazës së të dhënave të miratuara nga titullari i AMLF-së.

6. Niveli i aksesit në bazën e të dhënave është, si më poshtë vijon:

- AMLF-ja ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave në rolet:
 - administrator;
 - editues;
 - lexues.

b) Organizatori i licencuar i lojërave të fatit ka të drejta vetëm për shikim (lexues).



7. Regjistri do të jetë i aksesueshëm nga të gjithë organizatorët e lojës së kategorisë përkatëse, nëpërmjet kredencialeve të vendosura në dispozicion nga AMLF-ja.

8. AMLF-ja, në cilësinë e “kontrolluesit”, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, dokumenton masat tekniko-organizative të përshtatura e të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

9. Deri në ngritjen e regjistrit elektronik, kërkesa bëhet me shkrim. AMLF-ja informon të gjitha shoqëritë që veprojnë në fushën e lojërave të fatit lidhur me lojtarët e pasqyruar në regjister, si dhe për ndryshimet e të dhënave të tyre.

10. AMLF-ja ndërmerr të gjitha masat e nevojshme teknike dhe organizative për sigurimin e një ndërveprimi të kontrolluar dhe të mbrojtur me subjektet e licencuara, duke garantuar që çdo akses apo shkëmbim i informacionit të realizohet në mënyrë të sigurt, të dokumentuar e të gjurmueshme, në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në të gjitha fazat e ngritjes dhe të funksionimit të regjistrit.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Kërkesat për moslejimin për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit apo në faqe interneti, në aplikacione ose në platformë elektronike, ku mund të luhen lojëra fati, të kryera përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, mbeten në fuqi dhe mund të revokohen me kërkesë të personit që ka kërkuar moslejimin ose me kërkesë të vetë personit të ndaluar.

2. Ngarkohet Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 115, datë 27.2.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 206, DATË 7.4.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN E STRUKTURAVE DHE AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE PËR MENAXHIMIN INDIREKT DHE USHTRIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE DHE TË MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE DHE STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT INDIREKT TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EVROPIAN, NË KUADËR TË PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN RURAL TË INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN E PARAANËTARËSIMIT (IPARD III)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 11 e 12, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 206, datë 7.4.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin indirekt dhe ushtrimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të programit për zhvillimin rural të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPARD III)”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1, e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Struktura menaxhuese, e përbërë nga zyra mbështetëse e ZKA-së së dhe organi kontabël, si struktura të veçanta, drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i strukturës për menaxhimin e fondeve



të Bashkimit Evropian në ministrinë përgjegjëse për financat, nën përgjegjësinë e ZKA së, për zbatimin e programit IPARD III, sipas funksioneve të përcaktuara në këtë vendim dhe në përputhje me manualin e brendshme të procedurave dhe rregulloren e brendshme të ministrisë përgjegjëse për financat.”.

b) Kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimi “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me fjalët “... ministria përgjegjëse për financat ...”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 116, datë 27.2.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 966, DATË 2.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE DHE TË MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE DHE STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT INDIREKT TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EVROPIAN, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT IPARD II (2014–2020), SEKTORI I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 11 të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5, e vendimit nr. 966, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPARD II (2014–2020), sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturës menaxhuese

Struktura menaxhuese, e përbërë nga zyra mbështetëse e ZKA-së dhe organi kontabël, si struktura të veçanta, drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i strukturës për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian në ministrinë përgjegjëse për financat, nën përgjegjësinë e ZKA-së, për zbatimin e programit IPARD II, sipas funksioneve të përcaktuara në këtë vendim dhe në përputhje me manualin e brendshme të procedurave dhe rregulloren e brendshme të ministrisë përgjegjëse për financat.”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 117, datë 27.2.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 540, DATË 20.9.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, PËRGJEGJËSIVE DHE MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE E STRUKTURAVE PËR MENAXHIMIN INDIREKT TË ASISTENCËS FINANCIARE TË BASHKIMIT EVROPIAN NËN INSTRUMENTIN PËR ASISTENCËN E PARAANËTARËSIMIT 2021–2027 (IPA III)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 11 e 12 të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë,



përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 540, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)”, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Struktura menaxhuese e përbërë nga zyra mbështetëse e ZKA-së dhe organi kontabël, si struktura të veçanta, drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i strukturës për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian në ministrinë përgjegjëse për financat, nën përgjegjësinë e ZKA-së, për zbatimin e programit IPA III, sipas funksioneve të përcaktuara në këtë vendim dhe në përputhje me manualin e brendshme të procedurave dhe rregulloren e brendshme të Ministrisë së Financave.”

b) Në pikën 2, fjalët “... drejtorisë mbështetëse të ZKA-së ...” zëvendësohen me “... strukturës përkatëse ...”;

c) Në pikën 3, fjalët “... Drejtorisë së Fondit ...” zëvendësohen me “... strukturës përkatëse ...”.

2. Shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) një drejtori e veçantë në organikën e ministrisë përgjegjëse për politikën e punësimit, për programin operativ shumëvjeçar në fushën e punësimit të rinjve (2024–2027).”.

3. Në pikën 3, të nenit 17, fjalët “... të paktën një herë në vit ...” zëvendësohen me fjalën “... periodikisht ...”.

4. Në pikën 4, të nenit 19, fjalët “... për monitorimin e kapaciteteve ...” zëvendësohen me “... për vlerësimin dhe monitorimin e kapaciteteve ...”.

II. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 118, datë 27.2.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 541, DATË 18.6.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, TË PËRGJEGJËSIVE DHE TË MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE DHE STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT INDIREKT TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EVROPIAN, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT IPA II (2014–2020)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 11, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr. 541, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësi dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA II (2014–2020)”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturës së menaxhimit

Struktura menaxhuese, e përbërë nga zyra mbështetëse e ZKA-së dhe organi kontabël, si struktura të veçanta, drejtohet nga drejtori i



përgjithshëm i strukturës për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian në ministrinë përgjegjëse për financat, nën përgjegjësinë e ZKA-së, për zbatimin e programit IPA II, sipas funksioneve të përcaktuara në këtë vendim dhe në përputhje me manualin e brendshme të procedurave dhe rregulloren e brendshme të Ministrisë së Financave.”

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 119, datë 27.2.2026

**PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA
E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË
PRONAVE SHTETËRORE, NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DISA
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE, PËR
REALIZIMIN E PROJEKTIT TË
INVESTIMIT “PËR ZHVILLIMIN DHE
MENAXHIMIN E PRONAVE
SHTETËRORE”, ME NËNPROJEKTET
SI “KORPUSI I INSTITUCIONEVE TË
PAVARURA”, “QENDRA PËR
ZHVILLIMIN MULTIFUNKSIONAL
TIRANË” DHE “COPËZAT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, me NIPT:

M01917011D, të pronave shtetërore sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për realizimin e nënprojekteve të investimit.

2. Autorizimin e shoqërisë aksionare “Korporata e Investimeve Shqiptare”, vetë apo nëpërmjet entitetit të krijuar prej saj, për të vepruar si zhvillues i pronave me funksion vetëm publik, në emër dhe për llogari të pronarit shtet, për pronat shtetërore, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Korporata e Investimeve Shqiptare apo entiteti i krijuar prej saj zhvillon pronat e përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, në funksion të realizimit të nënprojekteve të investimit, të cilat kanë si qëllim, ndër të tjera, përmbushjen e interesit publik.

4. Autorizohen Korporata e Investimeve Shqiptare dhe institucionet e përcaktuara në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave e kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik, autoritetit, në pronësi, apo përgjegjësi administrimi të të cilit regjistrohet prona e re shtetërore që zhvillohet si rezultat i përmbushjes së kushtit të transferimit të pronës/autorizimit për zhvillim, apo përmbushjes së interesit të Korporatës, dhe të kushteve e nevojave për dorëzimin e pronës së re.

5. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për hapjen e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit privat për nënprojektet e investimit “Korpusi i institucioneve të pavarura” dhe “Qendra për Zhvillimin Multifunksional Tiranë”, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, për zhvillimin e pronave, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 2, nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes në përputhje me konceptidenë arkitekturore që do të dalë fitues nga konkursi ndërkombëtar. Shpenzimet për shërbimet e parashikuara në këtë pikë mbulohen nga buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare.

6. Autorizohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, që në të njëjtën procedurë, të asistojë Korporatën e Investimeve Shqiptare, nëpërmjet hartimit të termave të referencës për



projektidetë arkitekturore, hartimit të kriterëve të kualifikimit për projektuesit dhe kriterëve të vlerësimit paraprak e përfundimtar të projekteve arkitekturore.

7. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për negociimin me subjekte private dhe publike me qëllim lidhjen e kontratës përkatëse për zhvillimin e pronave të transferuara në pronësi apo për të cilat ka autorizim zhvillimi, në funksion të realizimit të nënprojekteve të investimit, bazuar në vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

8. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, vetë apo nëpërmjet subjekteve të krijuara prej saj, të kryejë veprimet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, institucionet publike kompetente për planifikimin e zhvillimin e territorit apo me institucione të tjera, në kuadër të realizimit të projektit të investimit si dhe të sigurojë regjistrimin, në emër të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare, sipas parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit, të pronave të reja shtetërore që do të krijohen në kuadër të nënprojekteve të investimit.

9. Në funksion të zhvillimit të pronave të përcaktuara në këtë vendim, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare për të proceduar, nëse është e nevojshme, me prishjen e objekteve, pjesë e pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2,

bashkëlidhur këtij vendimi, vetëm pasi ka siguruar vazhdimin e aktiviteteve të institucioneve publike që përdorin/administrojnë këto prona në ambiente të tjera deri në marrjen në dorëzim të ambienteve të reja të ndërtuara dhe në zbatim të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, ngarkohet Korporata të kryejë procesin e konsolidimit të pronave të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2 në rast se konstatohet mospërputhje midis gjendjes faktike dhe ligjore të pronës.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Instituti i Statistikave (INSTAT), Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioni i Prokurimit Publik, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1 PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi
			Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
8220	2/389	1036	1036	-	Shtet
8220	2/490	3032.5	3032.5	1110	Shtet
8220	2/491	3871.5	3871.5	1075	Shtet
3140	149/31	948.5	-	-	Shtet
8330	2/273	2474	2474	-	Shtet
8330	2/348	405	405	-	Shtet
8330	6/482	179	179	-	Shtet
8330	6/483	1504	1504	-	Shtet
8340	6/71	109	-	-	Shtet
8642	24/232	310.49	310.49	-	Shtet
8642	24/535	19509.66	19509.66	-	Shtet
8210	2/47	394.49	-	-	Shtet



SHTOJCA NR. 2

PRONAT ME FUNKSION PUBLIK PËR TË CILAT KORPORATA VEPRON SI ZHVILLUES

Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi
			Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
8150	4/281	2381	2381	759	Shtet
8150	4/831	3045.6	3045.6	-	Shtet

SHTOJCA NR. 3

INSTITUCIONET PUBLIKE TË CILAT LIDHIN MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT ME KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE

Ministria e Punëve të Brendshme, Instituti i Statistikave (INSTAT), Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

VENDIM

Nr. 120, datë 27.2.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN, TË KRITEREVE, TË MËNYRËS SË MBËSHTETJES DHE TË MASËS SË SHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR TË RINJTË NË PROGRAMIN E TALENTEVE RINORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 16/1, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka si objekt miratimin e rregullave për organizimin e Programit të Talenteve Rinore (në vijim, Programi), si dhe të kriterëve, të mënyrës së mbështetjes dhe të masës së shpërblimit financiar për të rinjtë përfitues në program.

2. Programi zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (në vijim, AKR-ja), në bazë të thirrjeve për aplikim për të rinjtë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

3. AKR-ja bashkëpunon me institucionet publike brenda vendit dhe me misionet diplomatike apo postet konsullore jashtë vendit për zbatimin e mbarëvajtjen e këtij programi.

4. Programi financohet nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, si dhe nga donacione ose të ardhura të

tjera, nga burime të ligjshme. AKR-ja financon pjesëmarrjen e të rinjve në kompeticionet e veprimtaritë zyrtare ndërkombëtare (në vijim, veprimtaria ndërkombëtare) dhe jep shpërblim financiar, bazuar në rezultatet e arritura prej tyre në veprimtaritë ndërkombëtare.

5. AKR-ja bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme dhe përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, kur nevojitet verifikimi i organizatorëve dhe i veprimtarisë ndërkombëtare apo për lehtësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendin pritës.

6. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme, në bazë të vlerësimit, përfshin përfituesit e këtij programi në aktivitetet publike të misioneve diplomatike apo posteve konsullore jashtë vendit për të promovuar arritjet e tyre dhe imazhin e Shqipërisë në platformat ndërkombëtare.

II. KRITERET, MËNYRA E MBËSHTETJES DHE MASA E SHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR PËRFTUESIT E PROGRAMIT

1. Kandidati ka të drejtë të përfitojë mbështetje financiare nga Programi, nëse plotëson në mënyrë kumulative kriteret e përgjithshme dhe një nga kriteret e posaçme, sipas përcaktimeve të pikave 2, 3 dhe 4 të këtij kreu.

2. Kriteret e përgjithshme për përfitimin e mbështetjes nga Programi janë, si më poshtë vijon:

a) Kandidati i përket grup-moshës rinore të përcaktuar në shkronjën “P”, të nenit 3, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, të ndryshuar;

b) Kandidati është shtetas shqiptar.

3. Kriteret e posaçme për përfitimin e mbështetjes nga Programi janë, si më poshtë vijon:



a) Kandidati është përzgjedhur për të përfaqësuar vendin në veprimtarinë ndërkombëtare në fushën e arsimit, në bazë të konkurrimit në nivel kombëtar, të organizuar apo të njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar;

b) Kandidati është përzgjedhur për të përfaqësuar vendin në një veprimtari ndërkombëtare të sportit individual, në bazë të konkurrimit në nivel kombëtar, të organizuar nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar ose nga një federatë sportive shqiptare;

c) Kandidati është përzgjedhur për të marrë pjesë në një veprimtari ndërkombëtare në fushën e artit, të kulturës, të edukimit, të shkencës e të teknologjisë të organizuar nga:

i. një organizatë ndërqeveritare;

ii. një qeveri e njohur ndërkombëtarisht;

iii. një nga 100 (njëqind) universitetet më të mira në botë, sipas fushës specifike të edukimit që përkon me fushën e veprimtarisë ndërkombëtare nga “*Times Higher Education*” – renditja botërore e universiteteve;

iv. një nga 500 (pesëqind) ndërmarrjet më të mëdha në botë, sipas renditjes botërore “*Fortune 500*”, për vitin e aplikimit;

v. rrjetet panevropiane të organizatave kulturore dhe krijuese, mbështetur nga Programi i Evropës Krijuese i Bashkimit Evropian;

ç) Kandidati është përzgjedhur si delegat zyrtar rinor ose nga programe të ngjashme përfaqësimi për të rinjtë të ngritura nga organizatat ndërqeveritare;

d) Kandidati është përzgjedhur për të përfaqësuar Shqipërinë ose trashëgiminë e saj kulturore, arsimore, shkencore, teknologjike apo sportive në veprimtarinë e organizuar një vend tjetër të konfirmuar nga misioni diplomatik apo posti konsullor i Republikës së Shqipërisë në vendin përkatës.

4. Kandidati që plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, mbështetet me përparësi në Program, nëse u përket grupeve të veçanta, si më poshtë vijon:

a) Ka statusin jetim;

b) Ka humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;

c) Është person me aftësi të kufizuara;

ç) Është person që ka statusin “viktimitë trafikimi” /“viktimitë e mundshme trafikimi”;

d) I përket pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane;

dh) Gëzon statusin e “Fëmijës në përkujdesjen e Republikës”;

e) I përket një familjeje në skemën e ndihmës ekonomike;

ë) Është fëmijë i vendosur në shërbimin e kujdestarisë së përkohshme.

5. Programi mbështet kandidatin, që përmbush kriteret e përcaktuara pikën 1 të këtij kreu, në mënyrat, si më poshtë vijon:

a) Njëpërmjet kompensimit të shpenzimeve të pjesëmarrjes në veprimtarinë ndërkombëtare;

b) Njëpërmjet dhënies së shpërblimit financiar, bazuar në rezultatin e arritur në veprimtarinë ndërkombëtare.

6. Kandidati ka të drejtë të përfitojë mbështetje financiare nga Programi, sipas mënyrave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 5, të këtij kreu, vetëm një herë gjatë zbatimit të një thirrjeje vjetore.

7. Përjashtimisht, kandidati ka të drejtë të përfitojë mbështetje financiare më shumë se një herë, gjatë së njëjtës thirrjeje vjetore, nëse në bazë të rezultatit të arritur në veprimtarinë ndërkombëtare, për të cilën ka përfituar financimin e Programit, i lind e drejta të marrë pjesë në një veprimtari ndërkombëtare të një niveli më të lartë. Në këtë rast, kandidati i nënshtrohet procedurës së aplikimit për përfitimin e mbështetjes financiare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

8. Kompensimi i shpenzimeve për pjesëmarrjen në veprimtarinë ndërkombëtare përfshin, si më poshtë vijon:

a) Shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje, përlllogaritur në bazë të distancës ajrore në kilometra, nga vendi i nisjes tek vendi i zhvillimit të veprimtarisë, sipas vlerës financiare të përcaktuar për distancat në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Shpenzimet e akomodimit përgjatë zhvillimit të veprimtarisë ndërkombëtare, të përlllogaritur në bazë të netëve të qëndrimit dhe vlerës së kompensimit financiar për natë qëndrimi, të përcaktuar për shtetin ku zhvillohet veprimtaria ndërkombëtare, sipas lidhjes 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) Shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje dhe akomodimi për një person shoqërues, kur kandidati është fëmijë apo është person me aftësi të kufizuara, që mbështetet me ndihmës personal, në bazë të



legjislacionit në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

9. Kompensimi i shpenzimeve për personin shoqërues përllogaritet, sipas rastit:

a) Në masën 50% të vlerës së përllogaritur për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit vajtje-ardhje dhe të akomodimit për kandidatin përfitues;

b) Në masën 150% të vlerës së përllogaritur për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit vajtje-ardhje dhe të akomodimit për kandidatin përfitues, kur shoqëron një grup prej 3 (tre) ose më shumë fëmijësh në të njëjtën veprimtari ndërkombëtare. Shuma financiare për kompensimin e shpenzimeve përllogaritet në masën 150% mbi vlerën e mbështetjes financiare të akorduar për njërin nga fëmijët, edhe në rastin kur numri i fëmijëve të shoqëruar në veprimtarinë ndërkombëtare është më i lartë se tre;

c) Në masën 100% të vlerës së përllogaritur për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit vajtje-ardhje dhe të akomodimit për kandidatin përfitues, që u përket grupeve të veçanta, sipas përcaktimit të pikës 4, të këtij kreu, apo për kandidatin përfitues me aftësi të kufizuara, që mbështetet me ndihmës personal.

10. Shpenzimet e tjera të nevojshme për pjesëmarrjen e kandidatit në veprimtarinë ndërkombëtare, si: pagesa për vizën, regjistrimin, sigurimin e shëndetit, transportin e brendshëm, trajtimin ushqimor etj., nuk përballohen nga Programi. Përgjatë, për kandidatët përfitues që u përket grupeve të veçanta, të përcaktuara në pikën 4 të këtij kreu, Programi do të ofrojë mbështetje financiare për mbulimin e këtyre shpenzimeve, në masën 10% të vlerës financiare të akorduar për kompensimin e shpenzimeve të akomodimit, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 8, të këtij kreu, me kusht që këto shpenzime nuk përballohen nga organizatorët e veprimtarisë ndërkombëtare apo nga palë të treta.

11. Programi nuk akordon mbështetje financiare, nëse nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se shpenzimet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 8, të këtij kreu, përballohen plotësisht nga organizatorët e veprimtarisë ndërkombëtare apo nga palë të treta. Nëse nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur këto shpenzime rezultojnë pjesërisht në ngarkim të organizatorëve apo palëve të treta, Programi kompenson diferencën midis vlerës së akorduar për

mbulimin e udhëtimit dhe të akomodimit e vlerës së kompensimit të shpenzimeve të përcaktuara në këtë vendim.

12. Shpërblimi financiar i jepet kandidatit përfitues bazuar në rezultatin e arritur në një veprimtari ndërkombëtare, të nivelit botëror, evropian e rajonal, sipas rasteve të mëposhtme:

a) Nëse kandidati klasifikohet nga vendi i parë deri në vendin e tretë, në renditjen përfundimtare të veprimtarisë ndërkombëtare;

b) Nëse kandidati fiton një nga çmimet e para sipas kategorive, akorduar në veprimtarinë ndërkombëtare, që, në bazë të rregullave të organizimit, nuk kryen renditje të përgjithshme të pjesëmarrësve.

13. Vlera e shpërblimit financiar i jepet kandidatit përfitues sipas rasteve të mëposhtme:

a) Në bazë të klasifikimit në renditjen individuale, sipas shkronjës “a”, të lidhjes 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Në bazë të klasifikimit në renditjen ekipore, sipas shkronjës “b”, të lidhjes 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) Për fitimin e njërit nga çmimet e para në veprimtarinë individuale, sipas shkronjës “c”, të lidhjes 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ç) Për fitimin e njërit nga çmimet e para në veprimtarinë ekipore, sipas shkronjës “ç”, të lidhjes 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Kandidati humb të drejtën e përfitimit të shpërblimit financiar, sipas përcaktimeve të këtij kreu, nëse për rezultatet e arritura në veprimtarinë ndërkombëtare parashikohet mundësia e dhënies së një shpërblimi financiar, përmes një programi të ndryshëm, të financuar nga shteti shqiptar, pavarësisht vlerës financiare të këtij shpërblimi.

III. RREGULLAT PËR ORGANIZIMIN E THIRRJES VJETORE DHE PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE NË PROGRAM

1. AKR-ja harton dhe shpall, në fillim të çdo viti kalendarik, thirrjen për ofrimin e mbështetjes financiare nga Programi dhe mundësinë për aplikimin e kandidatëve. Thirrja shpallet në faqen e internetit të institucionit dhe qëndron e hapur përgjatë të gjithë vitit kalendarik deri në shpenzimin e plotë të fondeve të akorduara për Programin.

2. Thirrja për aplikim përmban:

a) vlerën e mbështetjes financiare të akorduar për thirrjen;



b) udhëzimet për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit;

c) formularët e aplikimit;

ç) informacionin për kriteret dhe procedurën e vlerësimit të aplikimeve.

3. Aplikimi për mbështetjen financiare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, bëhet nga:

a) kandidati, nëpërmjet llogarisë së tij, në shërbimin përkatës në portalin “*e-Albania*”;

b) prindi ose kujdestari ligjor, kur kandidati është fëmijë, në shërbimin përkatës në portalin “*e-Albania*”;

c) personi shoqërues, nëpërmjet llogarisë së tij, në shërbimin përkatës në portalin “*e-Albania*” vetëm për përfitimin e mbështetjes financiare, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të pikës 8, të kreut II, të këtij vendimi.

4. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi, përfshin informacionin për kandidatin, veprimtarinë ndërkombëtare, organizatorët, mënyrën e përzgjedhjes së pjesëmarrësve, shpenzimet për pjesëmarrjen dhe personin shoqërues. Dokumentet që ngarkohen në portalin “*e-Albania*” janë, si më poshtë vijon:

a) Ftesa e pjesëmarrjes për kandidatin, lëshuar nga organizatorët e veprimtarisë ndërkombëtare;

b) Dokumenti i publikuar apo i lëshuar nga organizatorët e veprimtarisë ndërkombëtare, ku përcaktohen shpenzimet e mbuluara prej tyre apo të palëve të treta, për pjesëmarrjen e kandidatëve dhe/ose të personave shoqërues në veprimtarinë ndërkombëtare;

c) Vetëm për veprimtarinë ndërkombëtare të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, ngarkohet akti i miratimit të pjesëmarrjes së kandidatit, lëshuar nga ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar. Në këtë rast, akti përmban dhe konfirmimin, nëse institucioni financon apo jo, përmes fondeve të veta, pjesëmarrjen e kandidatëve dhe/ose të personave shoqërues në veprimtarinë ndërkombëtare;

ç) Vetëm për veprimtarinë ndërkombëtare të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, ngarkohet akti i miratimit të pjesëmarrjes së kandidatit dhe, sipas rastit, të personit shoqërues, lëshuar nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar apo federata sportive shqiptare. Në këtë rast, akti përmban edhe konfirmimin, nëse

institucioni përkatës financon apo jo, përmes fondeve të veta, pjesëmarrjen e kandidatëve dhe/ose të personave shoqërues në veprimtarinë ndërkombëtare;

d) Vetëm për veprimtarinë ndërkombëtare të përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, ngarkohet dokumenti i lëshuar nga misioni diplomatik apo posti konsullor i Republikës së Shqipërisë në vendin përkatës. Dokumenti konfirmon rëndësinë e veprimtarisë për promovimin e imazhit ose të trashëgimisë së Shqipërisë në vendin përkatës dhe mbështetjen e kandidatit për pjesëmarrjen në këtë veprimtari;

dh) Sipas rastit, dokumenti që vërteton se kandidati u përket grupeve të veçanta, sipas përcaktimit të pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi;

e) Sipas rastit, vendimi i komisionit mjekësor përkatës që kandidati është person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për përkujdesje personale;

ë) Çdo dokument tjetër që kandidati vlerëson të rëndësishëm për mbështetjen e aplikimit të tij.

5. Aplikimi për përfitimin e mbështetjes financiare, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi, përfshin informacionin për kandidatin, veprimtarinë ndërkombëtare, organizatorët, mënyrën e përzgjedhjes së pjesëmarrësve, rezultatet e shpallura dhe përmban një pikë të veçantë për deklarimin që kandidati nuk është përfshirë në një procedurë administrative, që synon përfitimin e shpërblimit financiar për rezultatin e arritur në veprimtarinë ndërkombëtare, në kuadër të një programi të ndryshëm, financiar nga shteti shqiptar. Dokumentet që ngarkohen në portalin “*e-Albania*” janë, si më poshtë vijon:

a) Çmimi, certifikata apo dokumenti zyrtar i lëshuar nga organizatorët e veprimtarisë ndërkombëtare, që vërteton rezultatin e arritur nga kandidati në këtë veprimtari;

b) Sipas rastit, dokumenti që vërteton se kandidati u përket grupeve të veçanta, sipas përcaktimit të pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi;

c) Çdo dokument tjetër që kandidati vlerëson të rëndësishëm për mbështetjen e aplikimit të tij.

6. Dokumentet që ngarkohen në portalin “*e-Albania*”, për aplikimin për përfitimin e mbështetjes financiare, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të pikës 9, të kreut II, të këtij vendimi, janë, si më poshtë vijon:



a) Raporti mjeko-ligjor, që vërteton se personi shoqërues është i aftë fizikisht e mendërisht, nëse personi është i ndryshëm nga prindi apo nga kujdestari ligjor i kandidatit përfitues apo personi është i ndryshëm nga ndihmësi personal i kandidatit përfitues me aftësi të kufizuara;

b) Vetëdeklarimi i personit për marrjen përsipër të detyrimeve dhe të përgjegjësisë për shoqërimin e kandidatit/ëve në veprimtarinë ndërkombëtare.

7. Dokumentet e aplikimit në thirrje, sipas përcaktimeve të këtij kreu, në momentin e ngarkimit në portalin “e-Albania” duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë, në origjinal ose të njësuara me origjinalin.

8. Afati i lejuar për dorëzimin e aplikimeve për përfitimin e mbështetjes financiare është, si më poshtë vijon:

a) Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara fillimit të veprimtarisë ndërkombëtare, sipas mënyrës së mbështetjes, të përcaktuar në pikën 3, të kreut 2, të këtij vendimi;

b) Jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike pas përfundimit të veprimtarisë ndërkombëtare, sipas mënyrës së mbështetjes, të përcaktuar në pikën 12, të kreut II, të këtij vendimi.

9. Përgjithësisht, do të pranohet aplikimi i dorëzuar përtej afatit të përcaktuar në pikën 8 të këtij kreu, kur, për shkak të kushteve dhe të afateve të zhvillimit të veprimtarisë ndërkombëtare, respektimi i këtij afati nga kandidati nuk do të ishte i mundur.

10. Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga shpallja e thirrjes për aplikim, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKR-së, ngrihet komisioni i vlerësimit. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, ku njëri prej tyre mban pozicionin e kryetarit të komisionit.

11. Anëtarët e komisionit duhet të kenë jo më pak se 2 (dy) vjet eksperiencë pune në fushën e rinisë.

12. Komisioni i vlerësimit ushtron këto detyra:

a) Administron e vlerëson të gjitha aplikimet e dorëzuara në thirrje;

b) Bën vlerësimin e aplikimeve, duke përcaktuar njëkohësisht vlerën e mbështetjes financiare, që do t’u akordohet përfituesve;

c) Harton e nënshkruan raportin e vlerësimit për çdo aplikim të dorëzuar në thirrje.

13. Komisioni i vlerësimit, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së aplikimit,

bën verifikimin e përmbushjes së kriterëve të thirrjes publike dhe, sipas rastit:

a) Merr vendimin për pranimin e aplikimit, duke përcaktuar edhe vlerën e mbështetjes financiare, që i akordohet përfituesit;

b) Merr vendimin për refuzimin e aplikimit për mbështetjen financiare. Ky vendim përmban, në çdo rast, edhe arsyet e refuzimit;

c) Kërkon informacion shtesë, nëpërmjet portalit “e-Albania”, në rastin kur aplikimi dhe dokumentacioni shoqërues nuk vërtetojnë përmbushjen e kriterëve të thirrjes, duke lënë një afat prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike për plotësimin e dokumentacionit. Aplikimi refuzohet, në rast se dokumentacioni nuk plotësohet brenda afatit të caktuar.

14. Komisioni i vlerësimit nuk shqyrton asnjë aplikim për mbështetje financiare, i dorëzuar përtej afatit të lejuar, sipas përcaktimeve të pikës 8 të këtij kreu, apo nuk mund të rivendoset në afat, në bazë të parashikimit të pikës 9 të këtij kreu.

15. Komisioni i vlerësimit shqyrton me përparësi aplikimin për mbështetje financiare të dorëzuar nga kandidati që u përket grupeve të veçanta të përcaktuara në pikën 4, të kreut II.

16. Vendimi për pranimin apo refuzimin e aplikimit për mbështetje financiare merret me shumicë votash nga anëtarët e komisionit të vlerësimit dhe i njoftohet kandidatit në portalin “e-Albania” me nënshkrim ose vulë elektronike.

17. Komisioni i vlerësimit, kur vërteton plotësimin e kushteve për akordimin e mbështetjes financiare, sipas përcaktimit të shkronjës “c”, të pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi, njofton personin shoqërues, duke i lënë një afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike për ngarkimin e dokumenteve të përcaktuara në pikën 6, të këtij kreu, në portalin “e-Albania”. Në rast se personi shoqërues nuk kryen aplikimin brenda afatit të caktuar, komisioni i vlerësimit njofton kandidatin përfitues dhe i kërkon të përcaktojë një person shoqërues të ndryshëm nga i pari.

18. Komisioni i vlerësimit, kur, nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidatit, konstaton që është përcaktuar më shumë se një person shoqërues, njofton e fton për dorëzimin e aplikimit, nëpërmjet portalit “e-Albania”, fillimisht:

a) personin shoqërues, të përcaktuar në aktin e miratimit të lëshuar nga ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar për pjesëmarrjen në



veprimtarinë ndërkombëtare, të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi;

b) personin shoqërues, të përcaktuar në aktin e miratimit të lëshuar nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar apo federata sportive shqiptare për pjesëmarrjen në veprimtarinë ndërkombëtare, të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi;

c) personin shoqërues, të përcaktuar në dokumentin e konfirmimit, të lëshuar nga misioni diplomatik apo posti konsullor i Republikës së Shqipërisë në vendin përkatës të zhvillimit të veprimtarisë, të përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi;

ç) personin shoqërues, prindi ose kujdestari ligjor, për pjesëmarrjen në veprimtarinë ndërkombëtare, të përcaktuar në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi.

19. Komisioni i vlerësimit, kur vlerëson se dokumentacioni i ngarkuar, sipas pikës 18 të këtij kreu, nuk është i plotë, njofton personin shoqërues, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, duke i lënë një afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike për plotësim. Në rast se personi shoqërues nuk plotëson dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të caktuar, komisioni i vlerësimit njofton kandidatin përfitues dhe i kërkon të përcaktojë një person shoqërues të ndryshëm.

20. Vendimi për pranimin ose refuzimin e aplikimit për mbështetje financiare për personin shoqërues merret nga komisioni i vlerësimit me shumicë votash, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur. Vendimi i komunikohet personit shoqërues, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, me nënshkrim ose vulë elektronike.

Procedura e akordimit të mbështetjes financiare për personin shoqërues lejohet të përsëritet vetëm 1 (një) herë me një person shoqërues të ndryshëm nga i pari, në rast se:

- a) komisioni i vlerësimit merr vendim refuzimi;
- b) personi shoqërues nuk paraqet aplikimin brenda afatit të përcaktuar në pikën 17 të këtij kreu;
- c) personi shoqërues nuk plotëson dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar në pikën 19 të këtij kreu.

Në rast se edhe aplikimi i dytë nuk depozitohet brenda afatit apo nuk paraqitet dokumentacioni i kërkuar, kandidati humbet të drejtën për përfitimin e mbështetjes financiare për shoqërimin në

veprimtarinë ndërkombëtare, në kuadër të këtij programi.

21. Ankimi ndaj vendimit të komisionit të vlerësimit për refuzimin e aplikimit apo për vlerën e përlogaritur të mbështetjes financiare, që i akordohet kandidati përfitues apo personit shoqërues, i drejtohet drejtorit të përgjithshëm të AKR-së, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

22. AKR-ja lidh marrëveshjen për mbështetjen financiare të kandidati përfitues dhe të personit shoqërues. Disbursimi i mbështetjes financiare bëhet nga AKR-ja tek llogaria bankare e përfituesit dhe e shoqëruesit të tij, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike nga nënshkrimi i marrëveshjes për mbështetjen nga Programi.

23. Kandidati përfitues dhe personi shoqërues dorëzojnë pranë AKR-së dokumentet justifikuese të udhëtimit dhe të akomodimit, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të veprimtarisë ndërkombëtare.

24. Kandidati përfitues ngarkohet me detyrimin e kthimit të mbështetjes financiare të përfituar sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi, në rastet kur, pa shkaqe të arsyeshme:

- a) nuk paraqitet në veprimtarinë ndërkombëtare;
- b) përjashtohet nga veprimtaria ndërkombëtare;
- c) nuk përmbyll veprimtarinë ndërkombëtare;
- ç) nuk dorëzon pranë AKR-së dokumentet justifikuese të udhëtimit e të akomodimit.

25. Personi shoqërues ngarkohet me detyrimin e kthimit të mbështetjes financiare të përfituar sipas përcaktimit të shkronjës “c”, të pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi, në rastet kur, pa shkaqe të arsyeshme:

- a) kandidati përfitues apo personi shoqërues nuk paraqitet në veprimtarinë ndërkombëtare;
- b) kandidati përfitues përjashtohet nga veprimtaria ndërkombëtare;
- c) kandidati përfitues nuk përmbyll veprimtarinë ndërkombëtare;
- ç) nuk dorëzon pranë AKR-së dokumentet justifikuese të udhëtimit e të akomodimit.

26. Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, shkaqe të arsyeshme do të konsiderohen sëmundje të menjëhershme apo ndërrim jete të personit apo një anëtar i familjes së tij, fatkeqësi natyrore, anulime



dhe vonesa të mjeteve të transportit, që nuk varen nga personi, të vërtetuara sipas dokumentit përkatës.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në ngritjen dhe funksionimin e sistemit elektronik për financimin e projekteve të dedikuara dhe të regjistrimit elektronik për të rinjtë, aplikimet për përfitimin e mbështetjes financiare në Program do të administrohen në format fizik, nëpërmjet rrugëve postare dhe nëpërmjet postës elektronike, pranë AKR-së, sipas informacionit të dhënë në thirrjen e publikuar në faqen zyrtare të internetit.

2. AKR-ja përgatit raportin vjetor të monitorimit të Programit, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për rininë.

3. Vlerësimi i ndikimit të mbështetjes financiare të Programit bëhet çdo 2 (dy) vjet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për rininë.

4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Rinisë për shpalljen e thirrjes për ofrimin e mbështetjes financiare nga Programi i Talenteve Rinore për vitin 2026, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministria përgjegjëse për rininë, ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja 1

VLERA E KOMPENSIMIT TË UDHËTIMIT SIPAS DISTANCËS

Distanca në km	Vlera e kompensimit
100–499	22 000 lekë
500–1999	31 000 lekë
2000–2999	40 000 lekë
3000–3999	57 000 lekë
4000–7999	115 000 lekë
Mbi 8000 km	170 000 lekë

Lidhja 2

VLERA E KOMPENSIMIT TË AKOMODIMIT SIPAS GRUP-SHTETEVE

Grup-shtetet	Vlera e kompensimit për natë qëndrimi
Austria, Belgjika, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Islanda, Irlanda, Itali, Lihtenshtejn, Luksemburg, Holanda, Norvegjia, Suedia, Andorra, Monako, San Marino, Vatikan, Ishujt Faroe, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada, Australia, Zelanda e Re, Bahrein, Kuvajt, Oman, Katar, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Brunei, Hong Kong, Japoni, Korea e Jugut, Makao, Singapor, Tajvan	6 000 lekë
Armenia, Azerbajxhan, Bjellorusi, Gjeorgjia, Moldavia, Ukraina, Algjeria, Egjipt, Izrael, Jordania, Liban, Libia, Marok, Palestina, Siria, Tunizi, Rusia; Bangladesh, Butan, Kamboxhia, Kina, Korea e Veriut, Indi, Indonezi, Laos, Malajzia, Maldive, Mongolia, Mianmar, Nepali, Pakistan, Filipine, Sri Lanka, Tajlanda, Vietnam Afganistani, Kazakistani, Kirgistani, Taxhikistani, Turkmeneistan, Uzbekistani, Iran ¹ , Irak, Jemen, Ishujt Kuk, Ishujt e Fixhi, Kiribati, Ishujt Marshall, Mikronezia, Nauru, Niue, Palau, Papua Guinea e Re, Samoa, Ishujt Solomon, Timori Lindor, Tonga, Tuvalu, Vanuatu Angola, Benin, Botsvana, Burkina Faso, Burundi, Kamerun, Kepi i Gjelbër, Afrika Qendrore, Çad, Komoros, Kongo, Kongo Demokratike, Bregu i Fildishtë, Xhibuti, Guinea Ekuatoriale, Eritrea, Esëatini, Etiopia, Gabon,	5000 lekë

¹ Programi nuk ofron kompensim të shpenzimeve për veprimtarinë ndërkombëtare të zhvilluar në territorin e Republikës Islamike të Iranit, deri sa të jetë në fuqi vendimi nr. 578, datë 31.8.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Islamike të Iranit”.



Gambia, Gana, Guinea, Guinea Bisau, Kenia, Lesoto, Liberia, Madagaskar, Malavia, Mali, Mauritania, Mauricius, Mozambik, Namibia, Niger, Nigeria, Ruanda, Sao Tome dhe Principe, Senegal, Sejshell, Sierra Leone, Somalia, Afrika e Jugut, Sudani i Jugut, Sudan, Tanzania, Togo, Uganda, Zambia, Zimbabve, Argjentina, Bolivia, Brazil, Kili, Kolumbia, Kosta Rika, Ekuadori, Salvador, Guatemala, Honduras, Meksika, Nikaragua, Panama, Paraguaj, Peru, Uruguaj, Venezuela, Antigua dhe Barbuda, Bahamas, Barbados, Belize, Kuba, Dominika, Republika Domenikane, Greanda, Guajana, Haiti, Xhamajka, Shën Kits dhe Nevis, Shën Luçia, Shën Vinsent dhe Grenadinet, Surinam, Trinidad dhe Tabago	
Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Lituania, Maqedonia e Veriut, Polonia, Rumania, Serbia, Turqi, Bosnje dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi.	4000 lekë

Lidhja 3

KLASIFIKIMI NË VEPRIMTARITË NDËRKOMBËTARE DHE SHPËRBLIMET

a. KLASIFIKIMI NË RENDITJE INDIVIDUALE		
Veprimtari botërore	vendi i parë	60 000 lekë
Veprimtari botërore	vendi i dytë	40 000 lekë
Veprimtari botërore	vendi i tretë	30 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i parë	50 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i dytë	30 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i tretë	20 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i parë	30 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i dytë	20 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i tretë	10 000 lekë
b. KLASIFIKIMI NË RENDITJE EKIPORE		
Veprimtari botërore	vendi i parë	50 000 lekë
Veprimtari botërore	vendi i dytë	40 000 lekë
Veprimtari botërore	vendi i tretë	30 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i parë	40 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i dytë	30 000 lekë
Veprimtari evropiane	vendi i tretë	20 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i parë	30 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i dytë	20 000 lekë
Veprimtari rajonale	vendi i tretë	10 000 lekë
c. KLASIFIKIMI NË VEPRIMTARI INDIVIDUALE		
Veprimtari botërore	një nga çmimet e para	50 000 lekë
Veprimtari evropiane	një nga çmimet e para	30 000 lekë
Veprimtari rajonale	një nga çmimet e para	20 000 lekë
ç. KLASIFIKIMI NË VEPRIMTARI EKIPORE		
Veprimtari botërore	një nga çmimet e para	50 000 lekë
Veprimtari evropiane	një nga çmimet e para	30 000 lekë
Veprimtari rajonale	një nga çmimet e para	20 000 lekë

**VENDIM****Nr. 121, datë 27.2.2026****PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT
QENDROR TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Krijimin e Inspektoratit Qendror të Arsimit Parauniversitar (në vijim “IQAP”), i cili organizohet dhe funksionon si person juridik publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin.

2. IQAP-i financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi. Buxheti i IQAP-it përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. IQAP-i ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare në Shqipëri, nëpërmjet inspektimit në arsimin parauniversitar.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE DHE
DETYRAT E INSPEKTORATIT QENDROR
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

1. IQAP-i ka këto funksione:

a) Verifikon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit parauniversitar me kuadrin rregullator në fuqi, nëpërmjet inspektimit;

b) Siguron unifikimin e praktikave të inspektimit në fushën e arsimit parauniversitar.

2. IQAP-i, në përmbushje të misionit dhe përgjegjësiwe funksionale të tij, është institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor nëpërmjet ushtrimit të funksionit të inspektimit dhe kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) Vlerëson përmbushjen e kritereve të licencimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve

arsimore private në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe i propozon ministrit dënimin administrativ plotësues të pezullimit apo heqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë;

b) Planifikon veprimtarinë e inspektimit në arsimin parauniversitar dhe harton programin vjetor e mujor, si dhe raportin vjetor të inspektimit, sipas parashikimeve të ligjit për inspektimin dhe atë në fushën e arsimit parauniversitar;

c) Informon publikun për veprimtarinë e inspektimit dhe vendimet e marra;

ç) Çdo detyrë tjetër të parashikuar në kuadrin ligjor për inspektimin dhe atë në fushën e arsimit parauniversitar.

**III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
INSPEKTORATIT QENDROR TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

1. IQAP-i organizohet në nivel qendror dhe ushtron juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet inspektorëve, të cilët atashohen edhe pranë drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar.

2. Veprimtaria e IQAP-it drejtohet nga kryeinspektori, i cili e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin, funksionimin, si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së institucionit.

3. Kryeinspektori i IQAP-it ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Emëron pas paraqitjes së listës me kandidatët fitues nga komisioni i rekrutimit dhe ecurisë në karrierë, i ngritur në përputhje me ligjin për inspektimin, dhe liron nga detyra inspektorët e IQAP-it, sipas parashikimeve në kuadrin ligjor në fuqi;

b) Emëron dhe liron nga detyra punonjësit administrativë të IQAP-it;

c) Zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të IQAP-it, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit përgjegjës për arsimin, pas marrjes së mendimit këshillimor të inspektorit të përgjithshëm;

ç) Nxjerr urdhra dhe udhëzime për veprimtarinë e strukturave të IQAP-it në fushën e inspektimit arsimor parauniversitar;

d) Bashkërendon veprimtarinë e IQAP-it me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën e arsimit parauniversitar;



dh) Siguron kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme për çështje që lidhen me mirëfunksionimin e IQAP-it;

e) Siguron zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e inspektimit arsimor parauniversitar, dhe kontrollojnë zbatimin e tyre nga strukturat inspektuese;

ë) Merr masat menjëherë për zbatimin e vendimeve të komisionit disiplinor ndaj inspektorëve;

f) Propozon pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Inspektoratit të Përgjithshëm ndryshime në aktet ligjore e nënligjore, me qëllim plotësimin dhe përmirësimin e legjislacionit përkatës.

4. Kryeinspektori i IQAP-it përgjigjet dhe raporton drejtpërdrejt pranë ministrit përgjegjës për arsimin, përveç rasteve kur ministri ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi në aparatën e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Inspektoratit të Përgjithshëm për veprimtarinë inspektuese.

5. Marrëdhëniet e punës së kryeinspektorit dhe inspektorëve të IQAP-it rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, dispozitave të ligjit për inspektimin dhe akteve nënligjore, në zbatim të tij. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të tjerë administrativë të IQAP-it rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

6. Struktura dhe organika e IQAP-it miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

7. IQAP-i identifikohet me stemën, logon dhe vulën zyrtare.

8. Stema e IQAP-it përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Inspektorati Qendror i Arsimit Parauniversitar”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”, të ndryshuar.

9. Vula e IQAP-it ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula e IQAP-it përmban dhe shënimin identifikues “Inspektorati Qendror i Arsimit Parauniversitar”.

10. Vula e IQAP-it prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Funksionet inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar transferohen pranë IQAP-it, sipas parimeve të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të IQAP-it, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar vazhdojnë funksionimin e tyre, sipas strukturave dhe organikave të miratuara.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për arsimin dhe inspektori i përgjithshëm të marrin masat për përgatitjen e strukturës e të organikës së IQAP-it, si dhe për ndjekjen e procedurave të emërimit të kryeinspektorit, sipas kuadrit ligjor në fuqi, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe të drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar, që ushtrojnë funksione inspektimi, vijojnë marrëdhëniet e punës pranë Inspektoratit Qendror të Arsimit Parauniversitar, sipas strukturës dhe organikës që do të miratohet.

5. Ngarkohen Inspektorati i Përgjithshëm dhe ministria përgjegjëse për arsimin të sigurojë ambientet, infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë nga ana e IQAP-it.

6. Në vendimin nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, të kreut II, dhe në shkronjën “a”, të pikës 8, të kreut III, fjalët “... dhe inspektimit ...” hiqen;

b) Pika 5, e kreut II, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Inspektorati i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Inspektorati Qendror i Arsimit Parauniversitar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 122, datë 27.2.2026

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT
SHQIPTAR TË INFORMACIONIT TË
KËRKIMIT SHKENCOR (ACRIS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325 datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor (në vijim ACRIS).

2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore ACRIS është Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (në vijim AKKSHI).

3. Sistemi ACRIS përbëhet nga të dhënat parësore të kërkimit shkencor dhe nga të dhënat dytësore.

a) Të dhënat parësore konsiderohen të dhënat e mbledhura nga AKKSHI, që kanë të bëjnë me:

i. të dhënat lidhur me institucionet, institutet, njësitë e veçanta të kërkimit shkencor dhe kërkuesit shkencorë, sipas Regjistrit Kombëtar të Institucioneve, instituteve, njërive të veçanta të kërkimit shkencor dhe kërkuesve shkencorë;

ii. të dhënat e projekteve kërkimore-shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, që financohen me fonde publike, ku të përfshihen të paktën titulli i projektit, fushat e kërkimit, qëllimi, shumat e projektit, financuesit, kohëzgjatja, partnerët;

iii. të dhënat e infrastrukturës, ku ushtrohet veprimtaria kërkimore-shkencore;

iv. listën e disertacioneve të doktoratave të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht;

v. listën e punimeve të diplomës së ciklit të dytë dhe të tretë, të mbrojtura, dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht;

vi. listën e përditësuar të kontributit shkencor të personelit akademik e kërkimor të institucioneve të

arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor e të personelit kërkimor të instituteve të tjera të kërkim-zhvillimit.

b) Të dhënat dytësore të sistemit konsiderohen të dhënat që merren nga të dhënat parësore të bazat e të dhënave, si më poshtë vijon:

b/1) Nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, si më poshtë:

- i. emri, atësia, amësia, mbiemri;
- ii. numri i identifikimit personal;
- iii. datëlindja, gjinia, vendlindja;
- iv. statusi civil;
- v. adresa e vendbanimit;
- vi. shtetësia;
- vii. të dhënat e kontaktit të aplikuesit;

b/2) Të dhënat identifikuese të kërkuesve shkencorë, shtetas të huaj, që merren nga Regjistri Elektronik Kombëtar për të Huajt në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

- i. numri unik i identifikimit të të huajit;
- ii. të dhënat nga dokumenti i udhëtimit të të huajit ose gjenealogjetet e vetëdeklaruar nga i huaji për rastet e përcaktuara në ligj, që përbëjnë skedën e të huajit;

b/3) Të dhënat parësore që merren nga portali unik qeveritar “e-Albania”, si më poshtë:

- i. kodi unik i përdoruesit;
- ii. kodi i shërbimit elektronik;

b/4) Të dhënat që merren nga Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL), si më poshtë:

i. të dhënat e regjistrimit të studentëve në çdo program studimi;

ii. numri i identifikimit të matrikullimit të studentit;

iii. informacioni për statusin për pajisjen me numër matrikullimi;

iv. mbështetja financiare dhe kreditë studentore;

v. struktura e institucioneve të arsimit të lartë;

vi. hapja, riorganizimi dhe mbyllja e IAL-ve, degëve, njërive kryesore, bazë e të programeve të studimit;

vii. programet e studimit me profilet e tyre, si dhe kuotat e pranimit në to;

viii. certifikimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukture për kuotat e pranimit në programet e studimit të ofruara nga IAL-të;

ix. udhëheqjet shkencore në programet e studimit për fitimin e gradës shkencore “Doktor”;

x. projektstatutet dhe ndryshimet statutores të IAL-ve;



xi. informacione për aktet e hapjes/riorganizimit dhe akreditimit të parë e periodik të IAL-ve e të programeve të studimit;

xii. regjistrimi i formave të diplomave dhe certifikatave, të cilat lëshohen nga institucionet e arsimit të lartë;

xiii. pajisja e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrat themeltarë të arritjeve akademike e të lëshimit të diplomave dhe të certifikatave;

xiv. njohja e njësimi i diplomave dhe i certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë;

xv. njohja e titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të huaj;

b/5. Të dhënat që merren nga Regjistri Tregtar, si më poshtë:

i. të dhënat që i përkasin themelimit dhe veprimtarisë së subjekteve tregtare;

ii. të dhënat që i përkasin çregjistrimit;

iii. çdo ndryshim në status dhe organizimi i subjektit tregtar;

iv. të dhënat që u përkasin regjistrimeve me vendim të autoritetit publik;

v. të dhënat e identifikimit për personin juridik, si: forma, emri, numri e vendi i regjistrimit dhe selia;

vi. të dhëna për dokumentet shoqëruese/akte dhe informacione që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistrë;

vii. të dhëna për ndërveprim dhe baza të dhënash të tjera;

viii. të dhënat që i përkasin numrit unik të identifikimit të subjektit;

ix. të dhënat për emrin e subjektit tregtar dhe emrin tregtar;

x. të dhëna për subjektet e huaja;

xi. të dhëna për kapitalin themeltar të anëtarëve/aksionarëve/ortakëve;

xii. kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët.

4. Dhënës të informacionit për sistemin janë:

a) subjektet publike dhe jopublike të kërkimit shkencor;

b) Qendra e Shërbimeve Arsimore;

c) ministritë përgjegjëse që realizojnë veprimtari kërkimore-shkencore nëpërmjet institucioneve/agjencive/instituteve/njësite të veçanta kërkimore-shkencore;

ç) punonjësit kërkimorë-shkencorë.

5. Individët kanë nivel aksesi, si lexues, nëpërmjet ndërfaqes së AKKSHI-t në internet dhe portalit unik qeveritar “e-Albania”.

6. Sistemi ACRIS ndërvepron me bazën e të dhënave shtetërore të:

a) Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile;

b) portalit unik qeveritar “e-Albania”;

c) Regjistrat Elektronik Kombëtar për të Huajt në Republikën e Shqipërisë;

ç) Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL);

d) Regjistrat Tregtar/Qendrës Kombëtare të Biznesit.

7. Institucioni administrues siguron që përpunimi i të dhënave personale në ACRIS të kryhet në përputhje me parimet dhe kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar ligjshmërinë, drejtësinë, transparencën, minimizimin e të dhënave, saktësinë dhe ruajtjen e tyre, vetëm për periudhën e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar të ruajtjes, të dhënat personale fshihen ose anonimizohen, sipas procedurave të miratuara nga institucioni administrues, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Niveli i aksesimit të lejuar për përdoruesit e bazës së të dhënave shtetërore ACRIS përcaktohet, si më poshtë vijon:

a) Për të dhënat lidhur me zotërimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë, institucionet e arsimit të lartë, si hedhës, AKKSHI, si gjenerues i të dhënave, dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, si gjenerues i të dhënave për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore dhe njohjen e titujve akademikë;

b) Për të dhënat lidhur me institucionet, institutet, njësitë e veçanta të kërkimit shkencor dhe kërkuesve shkencorë, AKKSHI, si hedhës dhe gjenerues i të dhënave;

c) Për të dhënat e projekteve kërkimore-shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, që financohen me fonde publike, AKKSHI, si hedhës dhe gjenerues i të dhënave;

ç) Për të dhënat për infrastrukturën kërkimore-shkencore, subjektet e kërkimit shkencor, si hedhës dhe gjenerues të të dhënave;

d) Për të dhënat lidhur me revistat kërkimore-shkencore që publikohen në Republikën e Shqipërisë, subjektet që zhvillojnë veprimtari kërkimore-shkencore, si hedhës, dhe AKKSHI, si gjenerues i të dhënave;



dh) Për të dhënat e publikimeve kërkimore-shkencore, kërkuesit shkencorë, si krijues, dhe AKKSHI, si gjenerues i të dhënave;

e) Lidhur me listën e disertacioneve të doktoratave të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, institucionet e arsimit të lartë, si hedhës;

ë) Lidhur me listën e punimeve të diplomës së ciklit të dytë e të tretë, të mbrojtura, dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, institucionet e arsimit të lartë, si hedhës;

f) Lidhur me listën e përditësuar të kontributit shkencor të personelit akademik e kërkimor të institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor e të personelit kërkimor të instituteve të tjera të kërkim-zhvillimit, institucionet e arsimit të lartë, si hedhës.

9. Në bazë të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”, rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij.

10. Palët zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut për çdo veprim në regjistër lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave personale, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë, konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemeve e të shërbimeve të përpunimit.

11. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, subjektet e kërkimit shkencor, të organizuar në institucione të kërkimit shkencor, institute dhe njësi të veçanta të kërkimit shkencor, të ngritura për të kryer veprimtari në fushën e shkencës e të kërkimit shkencor, institucionet e arsimit të lartë dhe kërkuesit shkencorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 123, datë 27.2.2026

PËR REVOKIMIN E TRANSFERIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË BASHKISË TIRANË DHE KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË KANCELARISË SË URDHRAVE DHE MEDALJEVE TË PASURIVE NR. 4/870 DHE NR. 4/871, NË ZONËN KADASTRALE 8270, ME VENDNDODHJE NË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve të pasurive nr. 4/870 dhe nr. 4/871, në zonën kadastrale 8270, me vendndodhje në Tiranë, sipas kartelave të pasurive dhe hartave kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim ushtrimin e detyrave funksionale administrative.

2. Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pasurive të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Pika 2, e vendimit nr. 406, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pjesëve takuese të pronës me emërtimin “Garda e Republikës, Garnizon”, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8270, me numër pasurie 4/134, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 815, datë 29.11.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme,



për Gardën e Republikës”, të ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Bashkia Tiranë, Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8270109062
(Nga 8270093080, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8270, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 4/870, Sipërfaqja Totale 4100 m2,
(Nga të Cilat Truall 4100 m2; Ndërtesë 938.3 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale TR-T-11;U-11, Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia Tirane, Rruga DORA D'ISTRIA, Ndërtesa Nr. ____, SH/K ____,
Apartamenti Nr. ____,
Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 32427, Dt. 23/09/2024), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA E TIRANES, Nr. Identifikimi/NIPT K11729002L, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i
Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia Tirane, Rruga BUL.DESH. E KOMBIT, Ndërtesa Nr. ____, SH/K ____,
Apartamenti Nr. ____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme, Nr. 32427, Datë: 23/09/2024
Regjistruar: Nr. 00060020, Datë: 10/10/2024

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____, me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____, Nr. ____, Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. ____, Datë: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afat i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbianër	Nr. Identifikimi/ NPT
00042071	24/10/2018		BASHKISE TIRANË I NDALOHET TE NDRYSHOJE DESTINACIONIN E PERDORIMIT TE PRONES SIPAS PIKES 4 TE VKM 406/2018		01/01/1900	0		

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afat i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbianër	Nr. Identifikimi/ NPT
59610	24/07/2024	Kufizim	Marrëveshje noteriale për vendosje garancie mbi pasurinë	1520 2/2	16/05/2024	999 vite	QENDRA "TRASHEGIMIA PER TE GJITHE - GARDA "	M41309451U

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: Tirane, Tirane, Nr.: DORA D'ISTRIA

DREJTORI
Filladi Dano



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Jug
Date: 2026.02.19 10:27:20 +02'00'
J7131503202026021910271272ASHK

Evdhoksa
a

Digitally signed by:
Evdhoksa Xoxa
Date: 2026.02.19
10:25:12 +02'00'

Thoma
Riza

Digitally signed by:
Thoma Riza
Date: 2026.02.19
10:59:35 +02'00'

Filladi
Dano

Digitally signed by:
Filladi Dano
Date: 2026.02.19
04:18:38 +02'00'

Shënim: Ky dokument është generuar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 8270

KODI UNIK: 8270109062

NUMRI PASURISË: 4/870

INDEKSI HARTËS: TR-T-11;U-11

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 1000

DREJTORI
Filladi Dano

Thoma Riza
Data e lëshimit: 2026.02.19

Digitally signed by:
Thoma Riza
Date: 2026.02.19 11:01:19 +02'00'

Filladi Dano
Data e lëshimit: 2026.02.19

Digitally signed by:
Filladi Dano
Date: 2026.02.19 04:18:22 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Jug
Date: 2026.02.19 11:01:19 +02'00'
J71315002D202602191101096014014

Shënim: Ky dokument është generuar dhe vulosur me anë të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDËRTESA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8270109063
(Nga 8270093080, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8270, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 4/871, Sipërfaqja Totale 20904.3m²,
(Nga të Cilat Truall 20904.3m²; Ndërtesë 1082.7m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale TR-T-11;U-11, Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia Tirane, Rruga DORA D'ISTRIA, Ndërtesa Nr. ____, SH/K ____,
Apartamenti Nr. ____
Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 32427, Dt. 10/10/2024), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA E TIRANES, Nr. Identifikimi/NIPT K11729002L, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i
Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia Tirane, Rruga BUL.DESH. E KOMBIT, Ndërtesa Nr. ____, SH/K ____,
Apartamenti Nr. ____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së
paluajtshme, Nr. 32427, Datë: 10/10/2024

Regjistruar: Nr. 00060020, Datë: 10/10/2024

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____, me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____, Nr. ____, Datë: ____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____

Regjistruar: Nr. ____, Datë: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00042071	24/10/2018		BASHKISË TIRANË I NDALOHEJ TE NDRYSHOJE DESTINACIONI N E PERDORIMIT TE PRONES SIPAS PIKES 4 TE VKM 406/2018		01/01/1900	0		

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____, Emërtimi i Aktit: ____, Nr. __, Datë: ____

Regjistruar: Nr. __, Datë: ____

Përshkrimi: Tirane, Tirane, Rr.: DORAD`ISTRIA

DREJTORI
Filadi Dano



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Jug
Date: 2026.02.19 10:27:50 +02'00'
J71315002D2026021910274261ASHK

*Shënim : Ky dokument është generuar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)*

Evdhoksia Xoxi
a

Digitally signed by:
Evdhoksia Xoxi
Date: 2026.02.19
10:26:05 +02'00'

Thoma Riza
Riza

Digitally signed by:
Thoma Riza
Date: 2026.02.19
11:01:24 +02'00'

Filadi Dano
Dano

Digitally signed by:
Filadi Dano
Date: 2026.02.19
04:19:14 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 8270

KODI UNIK: 8270109063

NUMRI PASURISË: 4/871

INDEKSI HARTËS: TR-T-11;U-11

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI
Filladi Dano

Thoma
Riza

Digitally signed by:
Thoma Riza
Date: 2026.02.19 11:04:16 +02'00'

Filladi
Dano

Digitally signed by:
Filladi Dano
Date: 2026.02.19 04:18:52 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Jug
Date: 2026/02/19 11:04:16 +02'00'
J71315002D202602191104059414014

Shënim: Ky dokument është generuar dhe vulozuar me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

SHpjegues

- PARCELA
- NDËRTESA



URDHËR

Nr. 27, datë, 13.2.2026

**PËR CAKTIMIN E
ZËVENDËSDREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
USHTRIMIN E KOMPETENCAVE DHE
DETYRAVE TË DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË GARDËS
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 19, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Caktimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë Drejtues i Lartë Simon Zereci, për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë.

2. Kompetencat e caktuara, sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë, por jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Urdhri nr. 212, datë 17.12.2025, i ministrit të Punëve të Brendshme, “Për caktimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendës drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë, Drejtues i Lartë Simon Zereci.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Albana Koçiu

URDHËR

Nr. 37, datë 2.3.2026

**PËR CAKTIMIN E
ZËVENDËSDREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË
SHTETIT PËR USHTRIMIN E
KOMPETENCAVE DHE DETYRAVE
TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM
TË POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 58, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”,

URDHËROJ:

1. Caktimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtues i Lartë Sokol Bizhga, për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendës drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues i Lartë Sokol Bizhga.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Albana Koçiu

URDHËR

Nr. 177, datë 20.2.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg*
2.	Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
3.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Krempmarch*
4.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
5.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
6.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Ludwigslust-Land*
7.	Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
8.	Nordrhein-Westfalen	Recklinghausen	Dorsten*
9.	Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*
10.	Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
11.	Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel*
12.	Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
13.	Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
14.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritzer*
15.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torglow-Ferdinandshof*
16.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
17.	Brandenburg	Oberhavel	Kremlitz*
18.	Baden-Württemberg	Alb-Donau-Kreis	Langenau*
19.	Niedersachsen	Cloppenburg	Bosel*
20.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Geldern*
21.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Goch*
22.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Rees*
23.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kevelaer*
24.	Niedersachsen	Vechta	Vechta*
25.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
26.	Brandenburg	Prignitz	Plattinburg*
27.	Niedersachsen	Diepholz	Barnstorf*
28.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Föhr-Amrum*
29.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Sylt*
30.	Niedersachsen	Emsland	Geeste*
31.	Niedersachsen	Stade	Fredenbeck*
32.	Niedersachsen	Harburg	Tostedt*
33.	Niedersachsen	Oldenburg	Ganderkesee*
34.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Pennetal/Loitz*
35.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Letschin*
36.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Wriezen*
37.	Hessen	Wetteraukreis	Rockenberg*
38.	Niedersachsen	Cloppenburg	Friesoythe*
39.	Brandenburg	Uckermark	Lychen*
40.	Nordrhein-Westfalen	Wesel	Kamp-Lintfort*
41.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Selsingen*
42.	Niedersachsen	Vechta	Goldenstedt*
43.	Thüringen	Nordhausen	Ellrich*
44.	Sachsen-Anhalt	Mansfeld-Südharz	Goldene Aue*
45.	Niedersachsen	Emsland	Lengden*
46.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Bremervörde*
47.	Niedersachsen	Oldendorf	Himmelpforten*
48.	Niedersachsen	Oldenburg	Harpstedt*
49.	Niedersachsen	Diepholz	Altes Amt Lemförde*
50.	Niedersachsen	Diepholz	Rehden*
51.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Miltzow*
52.	Sachsen	Meißen	Ebersbach*
53.	Bayern	Straubing-Bogen	Geiselhöring*
54.	Nordrhein-Westfalen	Rhein-Erft-Kreis	Hürth*
55.	Niedersachsen	Verden	Thedinghausen*
56.	Niedersachsen	Oldenburg	Großknicken*
57.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Rietberg*
58.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Verl*

59.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Trave-Land*
60.	Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Wietmarschen*
61.	Nordrhein-Westfalen	Coesfeld	Lüdinghausen*
62.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kleve*
63.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Leezen*
64.	Niedersachsen	Oldenburg	Dötlingen*
65.	Sachsen-Anhalt	Anhalt-Bitterfeld	Zerbst/Anhalt*
66.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Versmold*
67.	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Fehmarn*
68.	Niedersachsen	Aurich	Domum*
69.	Nordrhein-Westfalen	Viersen	Kempfen*
70.	Niedersachsen	Cloppenburg	Saterland*
71.	Niedersachsen	Osnabrück	Osterappeln*
72.	Sachsen	Leipzig	Grimma*
73.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Recknitz-Trebelitz*
74.	Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Gardelegen*
75.	Niedersachsen	Emsland	Haselünne*
76.	Brandenburg	Havelland	Ketzin/Havel*
77.	Baden-Württemberg	Schwarzwald-Baar-Kreis	Donauschlingen*
78.	Sachsen	Nordsachsen	Wernsdorf*
79.	Nordrhein-Westfalen	Hamm	Hamm*
80.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Sottrum*
81.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Wetzlar*
82.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Goldberg-Mildenitz*
83.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Bützow-Land*
84.	Niedersachsen	Göttingen	Gieboldehausen*
85.	Niedersachsen	Cloppenburg	Essen (Oldenburg)*
86.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Golzow*
87.	Hessen	Gießen	Hungen*
88.	Bayern	Cham	Furth im Wald*
89.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kranenburg*
90.	Sachsen-Anhalt	Jerchow/Land	Möckern*
91.	Sachsen	Leipzig	Geithain*
92.	Niedersachsen	Osnabrück	Artland*
93.	Sachsen-Anhalt	Harz	Ostervico*
94.	Brandenburg	Teltow-Fläming	Trebbin*
95.	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Eutin*
96.	Brandenburg	Ostprignitz-Ruppin	Heiligengrabe*
97.	Niedersachsen	Cloppenburg	Barfel*
98.	Nordrhein-Westfalen	Hochsauerlandkreis	Meschede*
99.	Thüringen	Kyffhäuserkreis	Kyffhäuserland*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.



7. Urdhri nr. 148, datë 11.2.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetën e Gjermanisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri**

**SEKSIONI I TRETË
VENDIM**

**Kërkesat nr. 45354/16 dhe 56514/21,
Arben BIÇAKU kundër Shqipërisë
dhe Klodian RJEPAJ kundër Shqipërisë
(shihni tabelën bashkëngjitur)**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 18 dhjetor 2025, si Komitet i përbërë nga:

Diana Kovatcheva, *President*,

Canòlic Mingorance Cairat,

Vasilka Sancin, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit*,

Duke pasur parasysh kërkesat më sipër të depozituara më 25 korrik 2016 dhe 16 nëntor 2021,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Lista e kërkesve jepet në shtojcë.

Ankimet e kërkesve, sipas nenit 6 dhe 8 të Konventës dhe nenit 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës, i janë komunikuar qeverisë shqiptare e cila dorëzoi parashtrimet për pranueshmërinë dhe themelin.

Parashtrimet iu dërguan kërkesve, të cilët u ftuan që të paraqesin parashtrimet e tyre me shkrim. Kërkesit nuk paraqitën asnjë përgjigje.

Me anë të shkresave të dërguara me postë rekomande dhe përmes Shërbimit të Komunikimit

Elektronik të Gjykatës (*eComms*), kërkesit dhe përfaqësuesit e tyre u njoftuan që periudha e lejuar për paraqitjen e parashtrimeve të tyre kishte mbaruar dhe që nuk ishte kërkuar shtyrje e afatit. Më tej, kërkesit u vunë në dijeni për nenin 37, paragrafi 1 (a) të Konventës, sipas të cilit Gjykata mund të vendosë të heqë nga lista e çështjeve një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se kërkesi nuk synon të vazhdojë ta ndjekë çështjen.

Megjithatë, nuk vijoi asnjë përgjigje.

LEGJISLACIONI

Gjykata e gjen të përshtatshme që të shqyrtojë kërkesat e tyre bashkërisht në një vendim të vetëm.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata del në përfundimin që mund të konsiderohet se kërkesit nuk dëshirojnë më të ndjekin kërkesat e tyre (neni 37, paragrafi 1 (a) i Konventës). Gjithashtu, në përputhje me nenin 37, paragrafi 1 *in fine*, Gjykata nuk gjen rrethana të veçanta, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, siç përcaktohen në Konventë dhe në Protokollin e saj sipas të cilave do të kërkohej vazhdimi i shqyrtimit të kërkesave.

Në këto rrethana, çështjet duhet të hiqen nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

vendos të bashkojë kërkesat;

vendos të heqë kërkesat nga lista e çështjeve të saj.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 22 janar 2026.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE
NË DETYRË

Diana Kovatcheva
PRESIDENT



SHTOJCË

Lista e kërkesave

Nr.	Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuessit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e shkresës rekomande të Gjykatës
1	45354/16 25.7.2016	Arben BIÇAKU 1975	Arben RAKIPI Tiranë	26.6.2025 (dorëzuar më 8.7.2025)
2	56514/21 16.11.2021	Klodian RJEPAJ 1971	Kostandin TRANDAFILI Tiranë	20.6.2025 (dorëzuar më 8.7.2025)

SEKSIONI I TRETË
VENDIM**Kërkesa nr. 385/22**
Mirelë BUZALLI kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 9 dhjetor 2025, si Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *President,*

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelar i Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

Kërkesën (nr. 385/22) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), më 20 shkurt 2020, nga shtetasja shqiptare znj. Mirelë Buzalli (kërkuese), e lindur në vitin 1979, e burgosur në Tiranë dhe e përfaqësuar nga z. F. Dashi, avokat i licencuar në Tiranë;

Vendimin për të njoftuar për kërkesën Qeverinë e Shqipërisë (Qeveria) të përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

Parashtimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi, si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Në vitin 2017, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda e dënoi kërkuessen për veprën penale të vrasjes. Në maj 2017, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda e la në fuqi atë vendim. Rekursi i kërkuesses pranë Gjykatës së Lartë u regjistrua më 19 qershor 2017.

2. Më 9 shtator 2021, avokati i kërkuesses depozitoi një dokument në Gjykatën e Lartë. Ai i drejtohej gjyqtarit S. B. të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Objekti i dokumentit të dërguar nga avokati ishte “kërkesë për përshpejtim të procesit në lidhje me rekursin”. Referuar nenit 399/2 të Kodit të

Procedurës Civile, ai theksoi që procesi në Gjykatën e Lartë në çështje penale duhej të përfundohej brenda një viti ndërsa rekursi i kërkuesses ishte në pritje që në vitin 2017.

3. Në tetor 2021, avokati i kërkuesses kërkoi një përditësim për statusin e procesit në Gjykatën e Lartë. Më 1 nëntor 2021, Kancelari i Gjykatës së Lartë njoftoi që çështja ishte në pritje të shqyrtimit.

4. Më 7 shkurt 2023, Gjykata e Lartë e rrëzoi rekursin e kërkuesses në çështjen penale.

5. Me kërkesën e kërkuesses në vitin 2024, gjykata e shkallës së parë i dha atij një kopje të dokumentit me datë 9 shtator 2021, që kishte vulën e Gjykatës së Lartë me numër regjistrimi (nr. 2937) dhe datë (9 shtator 2021).

6. Pas kërkesës së qeverisë së paditur në vitin 2024, Gjykata e Lartë njoftoi që regjistri i saj për kërkesat për përshpejtim të procesit nuk kishte të dhëna, në lidhje me ndonjë kërkesë të këtij lloji, në lidhje me çështjen penale të kërkuesses.

7. Kërkesja u ankua në Gjykatë që kohëzgjatja e proceseve asokohe në pritje në Gjykatën e Lartë përbënte shkelje të nenit 6 të Konventës.

VLERËSIMI I GJYKATËS**A. Parashtimet e palëve**

8. Qeveria pretendoi se kërkesja kishte abuzuar me të drejtën e saj për kërkesë sepse ajo u përpoq të keqinformonte Gjykatën për paraqitjen e kërkesës për përshpejtim të procesit në Gjykatën e Lartë. Dokumenti me datë 9 shtator 2021 nuk ishte depozituar asnjëherë në Gjykatën e Lartë dhe, pavarësisht kësaj, nuk ishte një kërkesë e mirëfilltë për përshpejtim, në përputhje me kërkesat ligjore. Ai dokument nuk përmbante “shkaqe mbi të cilat Gjykata e Lartë mund të kategorizonte çështjen”. Kërkesja nuk shteroi mjetet e brendshme juridike sepse, edhe nëse supozohet që ajo e kishte paraqitur kërkesën për përshpejtim, në mungesë të përgjigjes në lidhje me atë, kërkesja nuk u ankua në Gjykatën Kushtetuese. Qeveria iu referua vendimit të



Gjykatës Kushtetuese nr. 35/2021 dhe pretendoi se kjo e fundit mund t'i kushtojë vëmendje vonësës së shqyrtimit të një kërkesë përshpejtimi në Gjykatën e Lartë dhe mund të pranojë shkeljen e kërkesës për afat të arsyeshëm në procesin e çështjes penale në Gjykatën e Lartë dhe të urdhërojë përshpejtimin.

9. Kërkesja iu përmbajt kërkesës së saj. Gjithashtu, ajo tregoi që dokumenti i datës 9 shtator 2021 ishte regjistruar në Gjykatën e Lartë. Ai përmbante një kërkesë specifike për përshpejtim që, sidoqoftë, nuk ishte shqyrtuar asnjëherë si e tillë. Kështu, ajo i shteroi mjetet e brendshme juridike të ankimit për kohëzgjatjen e procesit në Gjykatën e Lartë.

B. Vlerësimi i Gjykatës

10. Gjykata nuk ka nevojë të shqyrtojë kundërshtimin e abuzimit sepse kërkesa pavarësisht kësaj është e papranueshme.

11. Së pari, e vlerëson të provuar që dokumenti me datë 9 shtator 2021 ishte marrë nga Gjykata e Lartë. Qeveria nuk kishte specifikuar ndonjë kërkesë formale ligjore për kërkesat e paraqitura sipas nenit 399/1 *et seq* të Kodit të Procedurës Civile, për njohjen e shkeljes së kërkesës për afat të arsyeshëm në procese në Gjykatën e Lartë ose për përshpejtimin e tyre. Megjithatë, është provuar që, pavarësisht marrjes së dokumentit nga Gjykata e Lartë, ai asnjëherë nuk është shqyrtuar si kërkesë për përshpejtim.

12. Sipas nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Lartë duhej të vendoste për kërkesën për përshpejtim brenda dyzet e pesë ditëve nga depozitimi i saj. Edhe pse nuk mori përgjigje ose një vendim gjyqësor pas mbarimit të afatit ligjor, kërkesja nuk ndërmori masa për të kërkuar nëse në lidhje me atë kërkesë kishte ndonjë proces në pritje, apo për të ankimuar kundër mosveprimit (shihni legjislacionin e brendshëm në *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, § 37, 12 tetor 2021).

13. Në çështjen *ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (nr. 39860/19 dhe 2 të tjerë, §§ 99–101, 27 maj 2025) Gjykata u shpreh që ankimi në Gjykatën Kushtetuese ishte një mjet juridik që duhej shteruar pasi Gjykata e Lartë të dilte me vendim për themelin e kërkesës për përshpejtim. Në këto rrethana, Gjykata rrëzoi ankimin e kërkuar për kohëzgjatjen e procesit për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike të brendshme. Në lidhje me tre kërkesit e tjerë, nuk lindi ky problem sepse, duke

mos marrë asnjë vendim nga Gjykata e Lartë, ata depozituan një ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese. Vërehet se këta kërkuar e bënë këtë gjë brenda një periudhe ndërmjet katër dhe shtatë muajve pas depozitimit të kërkesave të tyre për përshpejtim në Gjykatën e Lartë (ibid. §§ 8–9, 32–33 dhe 55–56). Në vitin 2021, Gjykata Kushtetuese nuk refuzoi kërkesat e tyre kushtetuese si të parakohshme dhe shqyrtoi themelin për afatin e arsyeshëm (ibid. §§ 10–12, 34 dhe 57–58).

14. Po njësoj, në këtë çështje, kërkesja e përfaqësuar nga avokati, duhej të ishte ankuar në Gjykatën Kushtetuese nëse vlerësonte që kërkesa e saj nuk po shqyrtohej me shpejtësi nga Gjykata e Lartë. Kjo do të ofronte edhe një mundësi për të përcaktuar nëse dokumenti i depozituar në Gjykatën e Lartë ishte kërkesë e mirëfilltë për përshpejtim. Në vend të kësaj, në shkurt 2022 – pesë muaj pas depozitimit të kërkesës në Gjykatën e Lartë – kërkesja depozitoi një ankim para kësaj Gjykate për kohëzgjatjen e procesit në Gjykatën e Lartë. Pra, ajo nuk i dha Gjykatës Kushtetuese mundësinë që të shqyrtonte atë ankim përpara shkurtit 2023, kur përfundoi procesi në Gjykatën e Lartë.

15. Në këto rrethana, ky ankim duhet të refuzohet sipas nenit 35, paragrafët 1 dhe 4, të Konventës për mosshterimin e mjeteve të brendshme juridike.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 22 janar 2026.

Olga Chernishova
ZËVENDËS KANCELAR
NË DETYRË

Úna Ní Raifeartaigh
PRESIDENT



SEKSIONI I TRETË
**ÇËSHTJA ZYBERI KUNDËR
SHQIPËRISË**

(Kërkesa nr. 24267/16)

VENDIM

STRASBURG

27 janar 2026

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Zyberi kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *President,*

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelar i Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

Kërkesën (nr. 24267/16) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) më 25 prill 2016 nga shtetasja shqiptare znj. Afërdita Zyberi (“kërkuese”), e lindur në vitin 1936, që ka ndërruar jetë në vitin 2021, dhe e përfaqësuar nga z. B. Asllani, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 16 dhjetor 2025;

Mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me akuzat për shkelje të të drejtave për gjykim të drejtë dhe respektimin e pronës nga autoritete të brendshme administrative dhe gjyqësore, në kontekstin e kthimit të pronës.

2. Referuar një vendimi gjyqësor të vitit 1994, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronës në Vlorë i vitit 1995 njohu pronësinë e disa personave mbi një sipërfaqe toke prej 14,000 m² tokë, duke kthyer 10,000 m² dhe duke kompensuar në natyrë 4,000 m². Kërkuesja kishte në pronësi 1,096 m². Titulli i saj i pronësisë mbi atë tokë ishte regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

I. GRUPI I PARË I PROCESJEVE

3. Kërkuesja paditi V.M dhe të tjerë, duke kërkuar “lirimin dhe dorëzimin” e truallit të zënë nga ndërtimet e tyre.

4. Në vitin 2003, një gjykatë rrëzoi ankimin e kërkueses. Në vitin 2005, Gjykata e Apelit Vlorë e revokoi atë vendim dhe ndërpreu procesin. Në vitin 2006, Gjykata e Lartë prishi vendimin e apelit dhe e ktheu çështjen në Gjykatën e Apelit. V.M argumentoi para Gjykatës së Apelit që banesa e tij nuk ndodhej në truallin e kërkueses dhe që ndërtesa në tokën e saj ishte e djalit të tij, A.M. Më pas gjykata caktoi një ekspert për të përcaktuar nëse palët e lartpërmendura kishin ndërtuar në tokën e kërkueses. Raporti i ekspertit përcaktoi që A.M. zinte një sipërfaqe toke 273 m², përfshirë një objekt që zinte 204 m². Një banesë që ndodhej jashtë pronës së kërkueses, i përkiste V.M, ndërsa ndërtesa e dytë që ndodhej brenda pronës së kërkueses është e A.M. Me vendim të 16 shkurtit 2009, Gjykata e Apelit urdhëroi V.M “të lirojë dhe t’i dorëzojë” kërkueses një sipërfaqe toke prej 273 m². Gjykata vlerësoi se gjetja e ekspertit ishte në kundërshtim me deklaratimet e V.M. në procese në pritje që në vitin 2003. Ai e kishte pranuar që kishte ndërtuar në një sipërfaqe prej 1,096 m² duke pretenduar që ndërtimet ishin bërë kohë më përpara se kërkueses toka t’i kthehej. Po njësoj, në raportin e përgatitur nga policia në vitin 1998, në lidhje me pezullimin e ndërtimit nga V.M., vetë ai e kishte nënshkruar dokumentin.

5. Më 10 prill 2009, Gjykata e Rrethit Vlorë nxori një urdhër ekzekutimi në lidhje me vendimin e 16 shkurtit 2009.

6. Më 12 maj 2011, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e 16 shkurtit 2009.

II. PROCEDURA E LEGALIZIMIT E V.M. DHE GRUPI I DYTË I PROCESJEVE

7. Ndërkohë, V.M filloi procedurë legalizimi sipas ligjit nr. 9482/2006, “Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 677, i 18 qershor 2009, “Për miratimin e kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale”, e miratoi kalimin e pronësisë. Siç specifikohet në atë vendim, bazohej, mes dispozitave të tjera, në nenin 17 të ligjit nr. 9482/2006 dhe nenin 4 (ç) të ligjit nr. 7980/1995, në lidhje me kalimin e pronësisë së parcelave nga shteti tek personat privatë; Këshilli i Ministrave udhëzoi



Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) për të kryer procedurat e kalimit të pronësisë “nga Shteti” tek poseduesit e ndërtimeve pa leje.

8. Në zbatim të vendimit të mësipërm, më 24 shtator 2009, zyra e Agjencisë së Legalizimit në Vlorë nënshkroi një kontratë me V.M. për kalimin e pronësisë për parcelën prej 300 m² dhe i dha atij një leje legalizimi më 25 prill 2011 për atë parcelë toke.

9. Kërkuesja dhe të tjerët paditën Zyrën e Agjencisë së Legalizimit Vlorë, duke kërkuar anulimin e procedurave për legalizim të ndërtimeve pa leje të bëra nga persona e tretë përfshirë lejen e legalizimit të V.M. të 25 prillit 2011. Me vendim të 20 korrikut 2011, Gjykata e Rrethit Vlorë u shpreh që Këshilli i Ministrave ishte kompetent për të vendosur për ligjshmërinë e kërkesave të legalizimit dhe kishte kompetencën ekskluzive për të autorizuar ALUIZNI-n që të përfundonte procedurat e kalimit të pronësisë të parcelave të tokës (ndërtime pa leje). Kështu, kërkuesja duhej të kishte kundërshtuar vendimin e Këshillit të Ministrave. Ajo nuk e kundërshtoi në ato procese apo veçmas.

10. Sipas qeverisë, Gjykata e Apelit Vlorë e la në fuqi atë vendim gjykate. Duket se vendimi i apelit doli më 16 dhjetor 2013, por më pas u prish më 7 qershor 2023 nga Gjykata e Lartë dhe këto procese janë akoma në pritje.

III. EKZEKUTIMI I VENDIMIT 2009 DHE GRUPI I TRETË I PROCESVE

11. Në dhjetor 2011, kërkuesja paraqiti në Zyrën e Përmbarimit urdhrin e ekzekutimit të 10 prillit 2009, për fillimin e procedurës së ekzekutimit në lidhje me vendimin e 16 shkurtit 2009 (shihni paragrafin 5 më sipër). V.M. u urdhërua që të lirojë parcelën e tokës në fjalë.

12. V.M. filloi procesin kundër kërkueses dhe përmbaruesve përpara Gjykatës së Rrethit Vlorë, me kërkesën për të bllokuar ekzekutimin. Gjykata vlerësoi se ai ngriti dy pretendime. Së pari, ai kundërshtoi ekzekutimin sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas tij, një debitor me vendim gjykate lejohet që të kundërshtojë si të pavlefshëm – bazuar në fakte që kanë ndodhur pas daljes së vendimit të gjykatës dhe brenda tridhjetë ditëve pas marrjes dijeni për procedurën e ekzekutimit – një urdher ekzekutimi të dhënë nga një gjykatë ose të pretendojë që detyrimi nuk ekziston ose ka pushuar së ekzistuari. Së dyti, V.M. kundërshtoi urdhrin e ekzekutimit të dhjetorit 2011, sipas nenit 610 të

Kodit që rregullon kundërshtimet ndaj vendimeve ose mosveprimeve përmbarimore.

13. Me vendimin e 23 shkurtit 2012, Gjykata e Rrethit pranoi pretendimet e tij, duke u shprehur si vijon:

a) Kur doli urdhri i ekzekutimit, V.M. nuk kishte dokumentet e pronësisë për tokën dhe ndërtimin në fjalë. Në vijim, ai ishte bërë pronar përmes një akti dhe procedure të ligjshme, dhe regjistrimi i të drejtave të tij të pronësisë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme ishte në proces e sipër. V.M. ishte në të njëjtën pozitë ligjore si kërkuesja. Ato fakte kishin ndodhur pas nxjerrjes së vendimit fillestar; kushtet për zbatimin e atij vendimi kishin ndryshuar dhe ekzekutimi i urdhrin të ekzekutimit nuk mund të shkelte të drejtat e një pronari të ligjshëm.

b) Në dhjetor 2011 përmbaruesi i kërkoi V.M. që të lirojë dhe të dorëzojë tokën dhe banesën e tij. Megjithatë, u vërtetua që urdhri i ekzekutimit nuk kishte të bënte me tokën dhe banesën që ai dispononte aktualisht, por “me sipërfaqen e zënë nga djali i tij A.M.”. Kjo ishte e dukshme edhe nga përmbajtja e vendimit të gjykatës dhe raporti i ekspertit, si edhe nga raporti i ekspertit të marrë për vendimin e gjykatës së 20 korrikut 2011 (shihni paragrafin 9 më sipër). Pra, kërkesa e përmbaruesit shkoi përtej urdhrin të ekzekutimit.

Gjykata e Rrethit pezulloi përkohësisht urdhrin e ekzekutimit dhe veprimet përmbarimore, në pritje të ankimit kundër vendimit të saj.

14. Më 3 maj 2013, Gjykata e Apelit Vlorë e la në fuqi vendimin gjyqësor të lart përmendur. Më 3 qershor, Gjykata e Lartë e la në fuqi vendimet gjyqësore të lartpërmendura në mënyrë të shkurtuar. Më 11 dhjetor 2015, Gjykata Kushtetuese vlerësoi që ato as nuk trajtonin objekt të njëjtë, as nuk adresonin çështje të njëjta të provuara dhe për të cilat është vendosur më parë me vendim të formës së prerë; prandaj, nuk është gjetur shkelje e sigurisë juridike.

VLERËSIMI I GJYKATËS

15. Referuar nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuesja u ankua që procedura e legalizimit në favor të V.M. dhe grupi i tretë i proceseve ndikuan negativisht në të drejtat e saj të pronës, ekzekutimin e vendimit të 2009 dhe shkelën parimin e sigurisë juridike.



I. LOCUS STANDI

16. Kërkuesja ndërroi jetë në vitin 2021. Në vitin 2025, vajzat dhe trashëgimtarët e saj, Fatmira Xhaxho dhe Silvana Pavaci, shprehën dëshirën për të ndjekur ankimet përpara Gjykatës. Qeveria theksoi që ato e kishin njoftuar Gjykatën për vdekjen e kërkueses vetëm në vitin 2025. Përfaqësuesi i kërkueses (që ka ndërruar jetën) ose, sipas rastit, të afërmit duhet të informojnë Gjykatën pa vonesë për të gjitha rrethanat që lidhen me kërkesën. Vonesa nuk është e dëshirueshme, por nuk sjell pasoja ligjore në këtë çështje. Këta persona legjitimohen për të ndjekur këto ankime (shihni *Ramaj kundër Shqipërisë*, nr. 17758/06, § 79, 10 dhjetor 2024). Gjykata do të vazhdojë t'i referohet znj A. Zyberi si "kërkuese".

II. ABUZIMI I PRETENDUAR ME TË DREJTËN PËR KËRKESË

17. Qeveria pretendoi që kërkuesja nuk e informoi Gjykatën për disa procese në lidhje me vendimin e gjykatës të 1994 dhe vendimin origjinal të kthimit të 1995 që janë akoma në proces (shihni paragrafin 2 më sipër). Kërkuesja nuk ra dakord.

18. Nuk është provuar që kërkuesja ka mbajtur informacion në përpjekje të qëllimshme për të keqinformuar Gjykatën, ose që ai informacion ka qenë i rëndësishëm për të përcaktuar pranueshmërinë dhe themelin e ankimeve. Rezultati i atyre proceseve nuk kishte aspak rëndësi për rezultatën e grupit të tretë të proceseve. Gjykata rrëzoi kundërshtimin e Qeverisë (shihni *B.T. dhe B.K.Cs. kundër Hungarisë*, nr. 4581/16, § 50, 10 qershor 2025).

III. SHKELJE TË PRETENDUARA TË NENIT 6 TË KONVENTËS DHE NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS NË LIDHJE ME VENDIMIN GJYQËSOR TË 16 SHKURTIT 2009.

19. Kërkuesja pretendoi se grupi i tretë i proceseve gjyqësore përbënte shkelje të sigurisë juridike në lidhje me vendimin gjyqësor të 16 shkurtit 2009 dhe pengoi ekzekutimin e tij.

A. Pranueshmëria

20. Në vitin 2009, kërkuesja siguroi një vendim gjyqësor që ishte titull ekzekutiv sipas legjislacionit të brendshëm dhe u konfirmua nga Gjykata e Lartë në maj 2011. Pas kësaj, kërkuesja mund të ankohej sipas Konventës, në lidhje me ekzekutimin e atij vendimi (krahasoni *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, § 33, 29 shtator 2009, dhe *Kural kundër Turqisë*,

nr. 84388/17, § 27, 19 mars 2024). Vendimi i vitit 2009 ishte objekt ekzekutimi ndërmjet dhjetorit 2011 dhe shkurtit 2012 kur gjykata e rrethit në çështjen e tretë (këtu e më poshtë "gjykata e rrethit") pezulloi ekzekutimin e tij. Vendimi gjyqësor nuk ishte më i ekzekutueshëm në vitin 2015 (shihni paragrafin 14 më lart).

21. Ankimet nuk janë haptazi të pabazuara sipas kuptimit të nenit 35 paragrafi 3 (a) të Konventës ose nuk janë të papranueshme bazuar në ndonjë shkak tjetër. Prandaj, ato duhet të shpallen të pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

22. Kërkuesja iu përmbajt kërkesës së saj.

23. Qeveria tregoi që sipas konceptit të sigurisë juridike, siç njihet në legjislacionin shqiptar, një vendim i formës së prerë është i detyrueshëm. Megjithatë, grupi i parë dhe i tretë i proceseve kishte objekte, palë dhe shkaqe veprimi të ndryshme. Gjykata në grupin e parë kishte urdhëruar riposëdëm kundër V.M., sepse ai ishte kryefamiljari i objektit që kishte zaptuar tokën së bashku me fëmijët e tij; A.M. nuk kishte qenë palë në proces. Gjykatat në çështjen e tretë nuk vunë në pikëpyetje pronësinë e kërkueses mbi tokën. Ato u bazuan në fakte të reja si procedura e legalizimit e V.M dhe në rezultatën e çështjes së dytë, gabimet e korrigjuara dhe të drejtat e mbrojtura të V.M.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

24. Parimet e përgjithshme në lidhje me përgjegjësinë e Palëve Kontraktuese sipas nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës në kontekstin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë kundër një pale private përmbledhen në çështjen *Immobiliare Saffi kundër Italisë* ([DHM], nr. 22774/93, §§ 49, 54, 64, 69 dhe 74, GJEDNJ 1999-V) dhe *Fuklev kundër Ukrainës* (nr. 71186/01, §§ 84 dhe 90-91, 7 qershor 2005).

25. Pra, pezullimi i ekzekutimit të një vendimi gjyqësor për këtë periudhë të nevojshme për të mundësuar gjetjen e një zgjidhjeje të kënaqshme për problemet e rendit publik mund të përligjet në rrethana të jashtëzakonshme (shihni *Immobiliare Saffi*, cituar më lart, § 69; shihni edhe *Fomenko dhe të tjerë kundër Rusisë* (vend.), nr. 42140/05 dhe 4 të tjerë, §§ 184-85, 24 shtator 2019). Një vendim gjyqësor që e bën gjithmonë të pamundur ekzekutimin e një vendimi përfundimtar të mëparshëm mund të



shkelë nenin 6 të Konventës ose nenin 1 të Protokollit nr. 1, kur ai vendim nuk është i justifikuar – për shembull, kur është dhënë në shkelje të parimit të sigurisë juridike (shihni *Margushin kundër Rusisë*, nr. 11989/03, §§ 31-40, 1 prill 2010).

26. Në lidhje me parimin e sigurisë juridike, ai nënkuptohet në të gjitha nenet e Konventës (shihni *Guðmundur Andri Astráðsson kundër Islandës* [DHM], nr. 26374/18, § 238, 1 dhjetor 2020, me referenca të mëtejshme). Ai shfaqet në forma dhe kontekste të ndryshme, si për shembull, duke kërkuar që pasi gjykatat të kenë marrë përfundimisht një vendim për një çështje, vendimi i tyre të mos vihet në diskutim. Ky aspekt i sigurisë juridike në përgjithësi presupozon respektimin e *res judicata*. Shmangiet nga siguria juridike dhe *res judicata* përligjen vetëm në rrethana me natyrë materiale dhe detyruese, për shembull, për shkak të defekteve thelbësore ose keqadministrimit të drejtësisë. Kundërshtimi i zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje në procese të ndara, kur vendimi gjyqësor fillestar nuk është revokuar formalisht, mund të shkelë parimin e sigurisë juridike (ibid, shihni edhe *Decheva dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, nr. 43071/06, § 39, 26 qershor 2012).

b) Zbatimi i parimeve në këtë çështje

27. Kërkesja fitoi titullin e pronësisë të tokës bazuar në legjislacionin që parashikonte kthimin/kompensimin e tokës së konfiskuar nga një regjim i mëparshëm. Pronësia e saj u regjistrua në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme dhe që në vitin 1988 ajo ndërmoi masa të vazhdueshme për të marrë tokën e saj në posedim (krahasoni *Ramaj kundër Shqipërisë*, nr. 17758/06, cituar më lart, §§ 134-37, 10 dhjetor 2024).

28. Sipas vendimit gjyqësor të vitit 2009, V.M. dhe familja e tij nuk kishin bazë ligjore për përdorimin e tokës së kërkuar dhe Gjykata e Apelit Vlorë e urdhëroi që ta lironte. Në vitin 2012, gjykata e rrethit bllokoi urdhrin e ekzekutimit sepse V.M. në vitin 2011 e kishte legalizuar objektin. Gjykata e rrethit e konsideroi lejen e legalizimit të V.M. – të nxjerrë ndërkohë që çështja në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të vitit 2009 ishte akoma në pritje – si një “fakt të ri” të krijuar pas atij vendimi; kjo pavarësisht faktit që leja e legalizimit të V.M ishte kundërshtuar në grupin e dytë të proceseve gjyqësore që asokohe ishin në pritje në gjykatën e apelit (shihni paragrafët 9, 10 dhe 12 më sipër). Duket se arsyetimi i gjykatës së rrethit është

kontradiktor. Nëse objekti i legalizuar nga V.M. do të ishte i ndryshëm nga ai që ndodhej në tokën e kërkuar, atëherë legalizimi do të ishte pa lidhje me vendimin gjyqësor të vitit 2009 dhe urdhrin e ekzekutimit, që i kërkonte V.M. lirim të tokës së kërkuar.

29. Gjithashtu, vendimi i Këshillit të Ministrave i 18 qershorit 2009, mbështetej në legjislacion për kalimin e pronësisë së tokës shtetërore të persona privatë dhe dukej se trajtonte tokën e regjistruar të kërkuar si tokë shtetërore (shihni paragrafin 7 më sipër). Pavarësisht vendimit gjyqësor për riposëdëm në favor të kërkuar, në prill 2011, një autoritet administrativ shqyrtoi kërkesën e V.M. për legalizim, duke lejuar legalizimin e objektit të paligjshëm dhe, sidomos, kalimin e pronësisë mbi truallin në fjalë nga pronari i parë (shteti ose person privat si në këtë çështje), me pagimin e kompensimit sipas rastit (shihni, për kontekst të përgjithshëm, *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (vend.) nr. 29026/06 dhe 11 të tjera, §§ 110-11 dhe 118, 17 mars 2020). Ajo procedurë administrative ndërhyrëse kishte pasojën që ndikoi drejtpërdrejt në riposëdëmin e kërkuar sipas vendimit gjyqësor të vitit 2009, pra pritshmërinë e saj legjitime për të përfutur nga rezultati i procesit të zgjatur gjyqësor për fitimin e të drejtave të pronësisë (krahasoni *Ramaj*, cituar më lart, § 111, dhe *Gaba kundër Shqipërisë*, nr. 33369/17, § 79, 17 dhjetor 2024).

30. Gjykata e rrethit në grupin e tretë të proceseve thjesht u shpreh që V.M. dhe kërkuarja – që kishin dukshëm pretendime konfliktuale për tokën – ishin në “të njëjtën situatë ligjore”. Gjithashtu, vendimi gjyqësor i korrikut 2011 në grupin e dytë të proceseve gjyqësore që kundërshtonte lejen e legalizimit iu nënshtrua rishikimit në apel (shihni paragrafët 9 dhe 10 më sipër). Pa dalë akoma vendim përfundimtar në ato procese gjyqësore gjykata e rrethit, në çështjen e tretë, pranoi vlefshmërinë e titullit të V.M. dhe urdhëroi ndërprerjen e procedurës së ekzekutimit.

31. Në përfundim, gjykata e rrethit iu referua mungesës së përgjegjësisë së V.M për objektin e paligjshëm në tokën e kërkuar. Ky argument u vlerësua i rëndësishëm për kundërshtimin nga V.M të procedurave përmbarimore (shihni paragrafët 12 dhe 13 më sipër). Natyra kontradiktore e arsyetimit të gjykatës së rrethit gjithashtu ndikoi në këtë aspekt të çështjes – sidomos në lidhje me kush dhe kur kishte ndërtuar, përdorur ose formalizuar pronësinë



e objektit, dhe si ndryshimet e mundshme në këto rrethana kishin ndikuar në veprimet përbarimore sipas vendimit të vitit 2009 (krahasoni *Vlahović kundër Malit të Zi*, nr. 62444/10, §§ 45-50, 22 shkurt 2024). Gjykatat nuk shpjeguan nëse V.M. ose A.M. kishin pronësi formale mbi objektin e paligjshëm të kundërshtuar në proces legalizimi, ndërkohë që kundërshtonin gjetjet e Gjykatës së Apelit të shkurtit 2009.

32. Vërehet që grupi i tretë i proceseve kishte të bënte me fazën e ekzekutimit të grupit të parë të proceseve. Të dyja proceset përfshinin të njëjtat palë (kërkuesja dhe V.M.) edhe pse në role të përmbysura. Në çështjen e parë, përgjegjësia e V.M. për objektin e paligjshëm në tokën e kërkueses ishte thelbësore dhe ishte vendosur në procese me palë kundërshtare, ku V.M. kishte marrë pjesë para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë (shihni *Decheva dhe të tjerë*, cituar më lart, §§ 41-42). Në çështjen e tretë, gjykata e rrethit rivlerësoi edhe provat e paraqitura më parë edhe provat e reja dhe doli në konkluzion të ndryshëm për të njëjtën çështje. Gjykata e rrethit bëri një shqyrtim material të një elementi thelbësor faktik të atij vendimi gjyqësor përfundimtar, duke u angazhuar kështu për rishikimin material *de facto* të tij me pretekstin e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit për ekzekutim.

33. Për arsyt e lartpërmendura, gjykata e rrethit nuk dha arsye bindëse për bllokimin e përhershëm të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të vitit 2009. As gjykatat më të larta nuk korrigjuan mangësitë në vendimin e gjykatës së rrethit. Pamundësia e ekzekutimit kundër një personi privat iu atribuua plotësisht këtyre vendimeve gjyqësore. Ato u bazuan në një vendim administrativ që ndërhyri në procesin e ekzekutimit dhe përmbante arsyetim kontradiktor dhe të pamjaftueshëm, në shkelje të sigurisë juridike. Prandaj, nuk mund të thuhet që Shteti i paditur ka vepruar në mënyrë të tillë që të vendosë ekuilibrin ndërmjet interesave të kërkueses dhe të V.M. në rrethanat e çështjes (krahasoni *Lasku dhe të tjerë kundër Shqipërisë* [Komiteti], nr. 6045/14, §§ 27 dhe 34, 18 nëntor 2025).

34. Prandaj në këtë çështje janë gjetur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 (ibid., §§ 27 dhe 32-35; *Margushin*, §§ 37-40; dhe *Decheva dhe të tjerë*, §§ 45 dhe 56-58, të dy të cituar më sipër).

IV. ANKIME TË TJERA

35. Në masën që kërkuesja mund të kuptohet se është ankuar sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 që i është hequr pronësia mbi tokën e saj (shihni paragrafët 7–10 më sipër), Gjykata ka përcaktuar problemet kryesore ligjore në këtë çështje, dhe nuk ka nevojë për shqyrtimin e kësaj çështjeje veçmas (krahasoni *Ramaj*, cituar më lart, § 140).

36. Në përfundim, Gjykata del në të njëjtin konkluzion në lidhje me referencat e kërkueses për mungesën e ndihmës nga Shteti në vitin 1998 për lirin e tokës së saj nga ndërtime të paligjshme, për mungesën e arsytimit në vendimin e Gjykatës së Lartë në qershor 2015 dhe, më e përgjithshme, për mungesën e mjeteve juridike efektive (neni 6 dhe 13).

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

37. Kërkuesja pretendoi për kosto dhe shpenzime pa dhënë specifikime dhe detaje. Gjykata e refuzon këtë pretendim.

38. Në Gjykatë nuk është paraqitur asnjë kërkesë për kompensim të drejtë për dëm pasuror apo jopasuror. Në këtë rrethana, Gjykatës nuk i kërkohet që të caktojë kompensimin.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. *Shprehet* që Fatmira Xhaxho dhe Silvana Pavaci legjitimohen për të ndjekur këto procese në vend të kërkueses;

2. *Rrëzon* kundërshtimin e Qeverisë për abuzimin e pretenduar me të drejtën për kërkesë;

3. *Shpall* të pranueshme ankimet sipas nenit 6 paragrafi 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës në lidhje me grupin e tretë të proceseve gjyqësore.

4. *Vendos* që është shkelur neni 6 paragrafi 1 i Konventës dhe neni 1 i protokollit nr. 1;

5. *Shprehet* që nuk ka nevojë të shqyrtojë ankimet e tjera;

6. *Rrëzon* pretendimin e kërkueses për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 27 janar 2026 sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELAR
NË DETYRË

Úna Ní Raifeartaigh
PRESIDENT

**KËRKESË****Nr. 368/6, datë 2.3.2026****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime, në vendimin nr 445, datë 31.7.2025, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Për zbatimin e projektit të portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto-Romano’”, me subjekt kërkuar Autoritetin Portual Durrës sh.a., sipas tekstit dhe tabelës paraprase, bashkëlidhur kësaj shkrese.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Portual Durrës sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprase të llogaritur për pasuritë e llojit “arë”, për llogaritur në bazë të VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të për llogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të

drejtave të personave të tretë, për interes public”, të ndryshuar, sipas tabelës paraprase bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Portual Durrës sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprase e shpronësimit është 35,193,448 (tridhjetë e pesë milionë e njëqind e nëtëdhjetë e tre mijë e katërqind e dyzet e tetë) lekë, ku efekti financiar shtesë është 4,247,080 (katër milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e tetëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA KËRKESA PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 445, DATË 31.7.2025, “PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË PORTIT TË RI TREGTAR TË INTEGRUAR TË DURRËSIT NË PORTO-ROMANO”

P R O N A R I				TË DHËNAT KADASTRALE (SI PAS KARTELËS SË PASURISË)										VLERËSIME TË PËRSPRONESIM										S h e m e r			
Nr.	Emri	Adresa	Mbeshtet	Fakultati ose spitali	ZK	Nr. i parcelës	Lloji i parrullës	Sipërfaqja totale (m²)	Ari (m²)	Trrall (m²)	Ndërtesat (m²)	Volumi	Faqe	ARË			TRUALL			NDËRTESE SOCIAL-EKONOMIKE			PALL			VLERA TËRTORE (faqe)	
														Sipërfaqja e abstraktuar (m²)	Gjatësi (tëq. m²)	Vlera (faqe)	Sipërfaqja e abstraktuar (m²)	Gjatësi (tëq. m²)	Vlera (faqe)	Sipërfaqja e abstraktuar (m²)	Gjatësi (tëq. m²)	Vlera (faqe)	Sipërfaqja e abstraktuar (m²)	Gjatësi (tëq. m²)	Vlera (faqe)		
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	W	X	Y	Z		
54	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALLË	8517	18/2	ARI	5,200				14	150	5,200	356	1,851,200										1,851,200.00	Kalifikim me ushtri dhejton ne 11042, date 13.8.2025 për 20 vjet nga APD përcaktues veprimet për paratë sipas shkresës nr. 2664/1 p.m., date 10.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale protokolluar në ASBK; Dents-Kavaj-Kroji me nr. 18613, date 11.12.2025, si dhe me shkresën nr. 2667/9 p.m., date 19.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale ka nisor procedurë e afshim publik prej date 22.12.2025 deri deri 4.2.2025, pasuria e përmirësuar/pedilës me nr. 090114153
55	MUHAMMEDI	BEJA	BARDHOCI	SPTALLË	8517	18/3	ARI	5,200				14	143	5,200	356	1,851,200										1,851,200.00	Dents-Kavaj-Kroji me nr. 18613, date 11.12.2025, si dhe me shkresën nr. 2667/9 p.m., date 19.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale ka nisor procedurë e afshim publik prej date 22.12.2025 deri deri 4.2.2025, pasuria e përmirësuar/pedilës me nr. 090114156
56	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALLË	8517	18/4	ARI	5,200				14	152	5,200	356	1,851,200										1,851,200.00	Kalifikim me ushtri dhejton ne 11042, date 13.8.2025 për 20 vjet nga APD përcaktues veprimet për paratë sipas shkresës nr. 2664/1 p.m., date 10.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale protokolluar në ASBK; Dents-Kavaj-Kroji me nr. 18613, date 11.12.2025, si dhe me shkresën nr. 2667/9 p.m., date 19.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale ka nisor procedurë e afshim publik prej date 22.12.2025 deri deri 4.2.2025, pasuria e përmirësuar/pedilës me nr. 090114158
57	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALLË	8517	18/5	ARI	5,500				14	153	5,500	356	1,958,000										1,958,000.00	Kalifikim me ushtri dhejton ne 11042, date 13.8.2025 për 20 vjet nga APD përcaktues veprimet për paratë sipas shkresës nr. 2664/1 p.m., date 10.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale protokolluar në ASBK; Dents-Kavaj-Kroji me nr. 18613, date 11.12.2025, si dhe me shkresën nr. 2667/9 p.m., date 19.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale ka nisor procedurë e afshim publik prej date 22.12.2025 deri deri 4.2.2025, pasuria e përmirësuar/pedilës me nr. 090114186
58	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALLË	8517	18/6	ARI	5,500				14	154	5,500	356	1,958,000										1,958,000.00	Kalifikim me ushtri dhejton ne 11042, date 13.8.2025 për 20 vjet nga APD përcaktues veprimet për paratë sipas shkresës nr. 2664/1 p.m., date 10.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale protokolluar në ASBK; Dents-Kavaj-Kroji me nr. 18613, date 11.12.2025, si dhe me shkresën nr. 2667/9 p.m., date 19.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale ka nisor procedurë e afshim publik prej date 22.12.2025 deri deri 4.2.2025, pasuria e përmirësuar/pedilës me nr. 090114197
60	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALLË	8517	18/8	ARI	5,500				14	156	5,500	356	1,958,000										1,958,000.00	Kalifikim me ushtri dhejton ne 11042, date 13.8.2025 për 20 vjet nga APD përcaktues veprimet për paratë sipas shkresës nr. 2664/1 p.m., date 10.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale protokolluar në ASBK; Dents-Kavaj-Kroji me nr. 18613, date 11.12.2025, si dhe me shkresën nr. 2667/9 p.m., date 19.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale ka nisor procedurë e afshim publik prej date 22.12.2025 deri deri 4.2.2025, pasuria e përmirësuar/pedilës me nr. 090114219
61	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALLË	8517	18/9	ARI	6,050				14	157	6,050	356	2,153,800										2,153,800.00	Kalifikim me ushtri dhejton ne 11042, date 13.8.2025 për 20 vjet nga APD përcaktues veprimet për paratë sipas shkresës nr. 2664/1 p.m., date 10.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale protokolluar në ASBK; Dents-Kavaj-Kroji me nr. 18613, date 11.12.2025, si dhe me shkresën nr. 2667/9 p.m., date 19.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale ka nisor procedurë e afshim publik prej date 22.12.2025 deri deri 4.2.2025, pasuria e përmirësuar/pedilës me nr. 090114230
62	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALLË	8517	18/10	ARI	8,700				14	158	8,700	356	3,097,200										3,097,200.00	D. 1) me ngjarjen 1807, date 6.2.2024, kalim pranisë me nensur (kalim, Komiteti shqiptar shqiptar me detyrime me nensur/kalim të paratës së palqyeshme nr. 4861 rep. nr. 2793 ka datë 29.12.2025 me afat 1 vje përfitim/kalim: Buzon Hyson Bardhoci dhe Hajrë Sakib Bardhoci. Kalifikim me ushtri dhejton ne 11042, date 13.8.2025 për 20 vjet nga APD përcaktues veprimet për paratë sipas shkresës nr. 2664/1 p.m., date 10.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale protokolluar në ASBK; Dents-Kavaj-Kroji me nr. 18613, date 11.12.2025, si dhe me shkresën nr. 2667/9 p.m., date 19.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale ka nisor procedurë e afshim publik prej date 22.12.2025 deri deri 4.2.2025, pasuria e përmirësuar/pedilës me nr. 090114231
63	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALLË	8517	18/11	ARI	8,550				14	159	8,550	356	2,972,600										2,972,600.00	Kalifikim me ushtri dhejton ne 11042, date 13.8.2025 për 20 vjet nga APD përcaktues veprimet për paratë sipas shkresës nr. 2664/1 p.m., date 10.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale protokolluar në ASBK; Dents-Kavaj-Kroji me nr. 18613, date 11.12.2025, si dhe me shkresën nr. 2667/9 p.m., date 19.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale ka nisor procedurë e afshim publik prej date 22.12.2025 deri deri 4.2.2025, pasuria e përmirësuar/pedilës me nr. 090114242
67	NAXHIBI ZEMRITË ZYRA FALIE REZAJE FERGJENT LIONTINA L. RRESA FATBARKHA REZAJE	RAJRAM VORKE VORKE VORKE OSMAN OSMAN MUSELI OSMAN	VOKA HALILAJ CAHANI VOKA PALUSHI OSMAN VOKA VOKA VOKA	SPTALLË	8517	19/4	ARI	5,070				14	220	5,070	356	1,804,320										1,804,320.00	D. Kalifikim me ushtri dhejton ne 11042, date 13.8.2025 për 20 vjet nga APD përcaktues veprimet për paratë sipas shkresës nr. 2664/1 p.m., date 10.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale protokolluar në ASBK; Dents-Kavaj-Kroji me nr. 18613, date 11.12.2025, si dhe me shkresën nr. 2667/9 p.m., date 19.12.2025 Qendra e Kadasitë Digtale ka nisor procedurë e afshim publik prej date 22.12.2025 deri deri 4.2.2025, pasuria e përmirësuar/pedilës me nr. 090114151
71	FETAH	ISUF	ELEZI	SPTALLË	8517	19/9	ARI	9,672				15	181	9,672	356	3,445,232										3,445,232.00	D. Kalifikim me ushtri dhejton ne 11042, date 13.08.2025, për 20 vjet nga APD

[illegible]

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë

